



02



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

INFORMALITETI

SFIDË E PËRBASHKËT
QEVERI-SIPËRMARRJE

Tiranë, Dhjetor 2015

PËRMBAJTJA

Ky Dokument Pune është përgatitur nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve në përmbushje të detyrave që rrjedhin nga axhenda e miratuar nga Këshilli i Investimeve në mbledhjen e datës 1 korrik 2015. Materiali është përgatitur nga specialistët e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve, znj. Ermelinda Xhaja, eksperte për ekonominë dhe z. Elvis Zerva, ekspert ligjor, nën drejtimin e Drejtores së Sekretariatit, znj. Diana Leka. Kontribut të veçantë në përgatitjen e materialit kanë edhe ekspertët znj. Valbona Ylli, dhe znj. Ani Dasho që kanë bashkëpunuar për çështjet e agro-industrisë dhe përpunimit të të dhënave. Mbështetje operationale është ofruar nga znj. Elisa Lula, asistente e Sekretariatit në organizimin e takimeve, mbarëvajtjen dhe promovimin e anketës, si dhe redaktimin e materialit. Falenderojmë të gjitha bizneset dhe shoqatat e biznesit që i janë përgjigjur anketës online dhe kanë diskutuar dhe ofruar mendime të vlefshme për temën e informalitetit, si edhe ekspertët e ndryshëm për sugjerimet e tyre të vlefshme. Pikëpamjet e paraqitura në këtë dokument janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht shprehin ato të Këshillit të Investimeve apo të BERZH-it.

I. HYRJE	4
II. KONTEKSTI	5
A.Aksioni kundër informalitetit	6
III. METODOLOGJIA	10
A.Hulumtimi i dokumentave	10
B.Takime individuale	12
C.Anketa Online	12
D.Rast Studimor – Sektori i Qumështit	12
IV. ANALIZA E INFORMALITETIT NË SHQIPËRI	13
A.Pikënisja e analizës	13
B.Gjetjet e Analizës	17
1. Sistemi Tatimor	18
2.Cilësia e Institucioneve	21
3.Aksesi në financim si një incentivë për formalizim	24
4.Masat ndëshkimore ndaj Informalitetit	24
5.Rast Studimor: Industria e Përpunimit të Qumështit	25
V. REKOMANDIMET	29
1. Reformë Formalizimi-Partneritet Me Biznesin	30
2.Sistem Tatimor i Përgjegjshëm kundrejt Formalizimit	30
3.Sistemi Rregullator, Mbështetës i Formalizimit	31
4. Aksesi në kredi dhe shërbimet financiare—faktorë incentivues për formalizimin	32
5.Konsultim, Transparencë dhe Edukim	33
SHTOJCA 1: MADHËSIA E EKONOMISË INFORMALE NË 27 VENDET E BE-SË NDAJ PBB-SË, 2003-2012	34
SHTOJCA 2: ANKETA	35
SHTOJCA 3: MATRICA PËRMBLEDHËSE E DISA EKSPERIENCAVE NËR KOMBËTARE NË REDUKTIMIN E EKONOMISË INFORMALE	38
SHTOJCA 4: LITERATURA	46

HYRJE

Ky punim u përgatit në kuadër të rekomandimeve të Mbledhjes së Parë të Këshillit të Investimeve (korrik 2015). Ai synon të strukturojë dhe nxisë debatin ndërmjet ekspertëve mbi një bazë sa më realiste dhe të japë rekomandime konkrete të gjeneruara nga biznesi duke synuar që formalizimi të ketë efekt dhe njëkohësisht të jetë sa më i balancuar në efektet sociale dhe një kosto sa më të ulët. Punimi merr në konsideratë: a) dinamikën e masave të ndërmarra kohët e fundit nga Qeveria si edhe reagimet e aktorëve të ndryshëm, b) problematikat që mbart në vetvete lufta kundër informalitetit, c) rekomandimet për një reformë të qëndrueshme ndaj informalitetit në partneritet me biznesin. Sugjerohet që biznesi të konsiderohet si partner kyç i Qeverisë për suksesin e kësaj Reforme sa të “vështirë” aq edhe të domosdoshme për të krijuar një ekonomi konkurruese. Informaliteti është një nga pengesat kryesore për reformat e tjera që synojnë forcimin e klimës së biznesit dhe rritjen e qëndrueshme të ekonomisë shqiptare. Lufta ndaj informalitetit është parakusht i rëndësishëm për një vend që synon të:

- » rrisë efikasitetin dhe konkurrueshmërinë e ekonomisë së vet;
- » përmirësojë klimën e investimeve;
- » sigurojë zbatimin e politikave të taksave të balancuara;
- » sigurojë një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe afatgjatë;

- » përmbushë detyrimet që lindin nga kuadri i marrëveshjeve me BE.
- Në bazë të analizave të kryera nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim¹ dhe FIAA (2015)², konkurrenca ndaj bizneseve të ndershme nga ekonomia gri dhe praktikrat korruptive janë identifikuar si pengesa kryesore në mjedisin e të bërit biznes në Shqipëri. Sipas BEEPS V, 40.2% e bizneseve shqiptare shprehen se konkurrohen në mënyrë të pandershme nga bizneset informale. Në këtë punim, është trajtuar informaliteti i evidentuar kryesisht në formën e bizneseve të paregjistruara, evazionit fiskal dhe mosdeklarimit të punonjësve. Analiza është fokusuar sidomos në njërin sektor të ekonomisë sikurse është ai i përpunimit të qumështit duke u përpjekur të nxjerrë në pah nevojën e studimeve të thelluara mbi zinxhirin e vlerës, por edhe rolin e incentivave për formalizim. Njëkohësisht, dokumenti trajton edhe domosdoshmërinë e bashkëpunimit dhe transparencës së dyanshme midis Qeverisë dhe biznesit si para kushte për suksesin e reformave. Do të sugjerohet që kjo Analizë të bëhet më e thelluar dhe e fokusuar në sektorë specifikë në 2016, duke marrë në konsideratë studimin e fundit të bërë për Shqipërinë nga OECD, zhvillimet deri më 2015, si edhe sfidatpër të ardhmen. Punimi është fokusuar në pesë shtylla kryesore:
- Reformë formalizimi ku biznesi të konsiderohet si partner;
 - Një sistem tatimor dhe administratë tatimore, e përgjegjshme ndaj formalizimit;
 - Sistemi rregullator, mbështetës i formalizimit;
 - Aksesi në kredi dhe shërbimet financiare, si
 - faktorë nxitës për formalizimin;
 - Konsultimi, transparenca dhe edukimi i tatimpaguesve.

¹ BEEPS IV dhe BEEPS V- "Vrojtimi për Klimën e Biznesit dhe Performancën e Sipërmarrjeve".

² BEEPS IV dhe BEEPS V- "Vrojtimi për Klimën e Biznesit dhe Performancën e Sipërmarrjeve".

KONTEKSTI

DY FJALË PËR KONCEPTIN

Deri më sot nuk ka një përkufizim të vetëm të nocionit të “informalitetit” apo të “ekonomisë informale”. Informaliteti apo ekonomia informale analizohen në mënyra të ndryshme këndvështrimi dhe i referohen një numri të lartë veprimtarish. Kjo është arsyeja përse jo vetëm përkufizimi, por edhe emërtimi janë objekt diskutimi. Ekonomia informale njihet në praktikë edhe si “ekonomia në hije”, “ekonomia cash” “ekonomia e fshehur”, “ekonomia e paligjshme”, “sektori informal”, “ekonomia nëntokësore” etj. Informaliteti ka filluar të bëhet objekt i diskutimeve dhe rretheve akademike të ekonomistëve nga vitet ‘50 dhe ‘60³. Ky fenomen ekonomik u analizua në vitin 1972 nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), nën emrin “*sektori informal*”⁴. Ndërkohë që sot informaliteti përbën një problem të identifikuar dhe serioz edhe në vendet e zhvilluara përfshirë edhe vendet e BE⁵.

³ Klarita Gërxhani – “Informal Sector in Developed and Less Developed Countries: A Literature Survey”.

⁴ Klarita Gërxhani – “Informal Sector in Developed and Less Developed Countries: A Literature Survey”.

⁵ Policy Brief on Informal Entrepreneurship, European Commission and OECD – Vendet e Europës Lindore dhe Juglindore me përjashtim të Çekisë dhe Sllovakisë kanë një nivel më të ulët të informalitetit në raport me mesataren e BE,

Një aspekt i rëndësishëm i “*ekonomisë informale*” i referohet edhe “*ekonomisë kriminale*”, pra asaj që rezulton nga prodhimi i produkteve dhe shërbimeve në mënyrë të kundërligjshme dhe nga aktivitete të ndaluara me ligj. Dallimi midis tyre konsiston se në *ekonominë kriminale* ajo që është e ndaluar është vetë aktiviteti, ndërsa në *ekonominë informale*, aktiviteti është i ligjshëm në vetvete, por të ardhurat prej tij fshihen dhe shmangen me anë të mjeteve të paligjshme⁶. Një përkufizim tjetër për “informalitetin” është ai që i referohet “*çdo aktiviteti ligjor ekonomik që zhvillohet jashtë radarëve të kontrollit të qeverisë*”. **Në këtë kuptim, informaliteti i referohet aktiviteteve ekonomike që normalisht janë objekt i taksave dhe tatimeve dhe përjashton të gjitha llojet e aktiviteteve që konsiderohen në mënyrë të qartë nga legjislacioni si të paligjshme (trafikimi i drogës, trafikimi armëve, pastrimi parasë, etj.)**⁷. Kjo e fundit është qasja më e përhapur lidhur me *informalitetin* dhe *ekonominë informale* dhe që është mbajtur parasysh nga Sekretariati gjatë përgatitjes së këtij punimi.

ndërsa vendet e Europës Perëndimore dhe Veriore kanë shifra të informalitetit në nivelin mesatar të BE - “The size of the informal economy in the EU-27, 2003-2012 – As a percentage of national GDP”.

⁶ Qëllimi i luftës kundër informalitetit në ekonominë informale është formalizimi i aktiviteteve që janë informale me qëllim deklarimin e të ardhurave që nuk janë deklaruar, ndërsa qëllimi i luftës ndaj informalitetit në ekonominë kriminale (pastrimi i parave, trafiket e paligjshme, etj.) lidhet me domosdoshmërinë e eliminimit të këtyre sektorëve dhe rrjedhimisht të të ardhurave që rrjedhin prej tyre.

⁷ Economic Informality: Causes, Costs, and Policies - A Literature Survey of International Experience, Background Paper prepared by Ana-Maria Oviado for Country Economic Memorandum (CEM) – Informality: Causes, Consequences, Policies, Qershor 2009, faqe 8.

1. AKSIONI KUNDËR INFORMALITETIT

Nga 1 shtator 2015, Qeveria Shqiptare filloi zyrtarisht një aksion të gjerë ndaj informalitetit në vend. Fillimit të këtij aksioni i paraprinë deklaratat publike gjatë muajve korrik-gusht 2015 lidhur me domosdoshmërinë e vendosjes së plotë të rendit ligjor në hapësirën e aktivitetit ekonomik dhe tregtar në vend. Nisja e aksionit u parapri nga një sërë hapash konkrete të ndërmarra nga Qeveria, duke filluar nga ngritja e një grupi pune brenda Këshillit të Ministrave, diskutimet në Komitetin Ndërmintor të Planifikimit Strategjik (KPS) dhe prezantimi i aksionit në Këshillin Ekonomik Kombëtar (KEK), por ende të papublikuara.

Procesi u shoqërua me një numër të lartë të kontrolleve tatimore (vizita fiskale) në terren me qëllim skanimin e situatës së informalitetit, deklaratat të shumta në media nga të gjithë grupet e interesit dhe vijoi me një sërë iniciativash ligjore. Ndërkohë është evidentuar një intensitet “unik” debati dhe reagimi në lidhje me aksionin që ka përfshirë Qeverinë, biznesin dhe shoqatat përfaqësuese të tij, si edhe institucionet ndërkombëtare.

Më poshtë jepet një përmbledhje në rend kronologjik i veprimeve më kryesore të ndërmarra nga Qeveria si edhe reagimet më të rëndësishme të biznesi në lidhje me aksionin kundër informalitetit:

1. Në korrik 2015 dhe në vijim pati një intensifikim të deklaratave publike të dhëna nga ana e Qeverisë Shqiptare për publikun në përgjithësi dhe biznesin në veçanti, lidhur me domosdoshmërinë e kryerjes së një aksioni kundër informalitetit, i cili në thellim do të synonte kthimin e bazave të konkurrencës së ndershme në treg si edhe mbrojtjen e konsumatorëve nga praktikat

abuzive të biznesit. Duket se momenti i nisjes së aksionit u kushtëzua në një masë të konsiderueshme edhe nga mosrealizimi i objektivave lidhur me të ardhurat e buxhetit në 6-mujorin e parë të vitit 2015.

2. Në mbledhjen e Këshillit Ekonomik Kombëtar (31 gusht 2015), Kryeministri i Shqipërisë prezantoi për biznesin aksionin kundër informalitetit, ndërsa Ministri i Financave sqaroi planin e masave.⁸ Aksioni përbëhej nga 2 faza: plani i veprimit afat shkurtër; dhe hartimi i një plani veprimi 2-vjeçar (përfundimtar dhe gjithëpërfshirës). Plan i afatshkurtër përbëhej nga tre komponentë të lidhur me: komunikimin (ndërgjegjësimi i publikut, biznesit dhe administratës publike për rëndësinë që ka lufta ndaj informalitetit); legjislacionin (ashpërsimi i masave ligjore për moszbatuesit e ligjit, masave ligjore për administratën tatimore dhe doganore, si i she ndryshime ligjore për rritjen e incentivave për zbatimin e ligjit); terrenin (identifikimi i zonave, sektorëve, bizneseve me risk të lartë, krijimi i një taskforce të përbashkët me përfshirjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD), Sektorit kundër Krimit Ekonomik dhe Inspektoratit të Punës).

3. Në funksion të një lufte efektive ndaj informalitetit në vend, më 17 shtator 2015 u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit për Luftën kundër Evazionit dhe Informalitetit midis Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Qëllimi

8 Burimi <http://kek.al/njoftime/takim-i-keshillit-ekonomik-kombetar/>

i Memorandumit është formalizimi i bashkëpunimit institucional të qëndrueshëm për të hetuar evazionin në tatime dhe dogana dhe ngritjen e strukturave të posaçme ndër-institucionale kundër informalitetit, duke ju referuar modelit të ndjekur në vitin 2014 për aksionin në fushën e pagesës së energjisë elektrike. Gjithashtu në këtë drejtim janë nënshkruar edhe disa Marrëveshje Bashkëpunimi midis Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, të cilat kanë patur si qëllim koordinimin e përpjekjeve në funksion të përmbushjes së prioritetit: **luftë kundër informalitetit.**

4. Nisja e aksionit u shoqërua me iniciativë ligjore⁹ nga ana e Qeverisë me qëllim ashpërsimin e masave administrative dhe penale ndaj bizneseve të cilët ushtrojnë aktivitet ekonomik të pa regjistruar, pa pajisje fiskale sipas kriterëve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi apo ndaj subjekteve të cilat nuk kryenin deklarimin real të të ardhurave apo të punonjësve të tyre, etj.

5. Ndryshimet e propozuara në ligjin “Për Procedurat Tatimore” dhe ato në Kodin Penal edhe pse u shoqëruan me një debat të ashpër publik sa i përket proporcionalitetit të tyre, sërish u miratuan nga Kuvendi i Shqipërisë¹⁰.

6. Në fund të muajit shtator 2015 nga

9 Ligji Nr. 99/2015 “Për ndryshime dhe shtesa në Ligjin për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe Projekt-ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”.

10 Ligj Nr. 99/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe Ligji Nr.

ana e Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes u njoftua zbatimi i *Modelit të Riskut* mbi bazën e të cilit DPT do të përzgjedhë bizneset me kategori të lartë risku si subjekte të kontrollit tatimor. Gjithashtu, DPT publikoi strategjinë 2014-2017 në fushën e tatimeve. Më 2 tetor 2015 publikut ju prezantuan edhe disa masa të Qeverisë në fushën ndaj informalitetit lidhur me sektorin e transportit.

7. Aksioni u shoqërua me raportime në media nga ana e bizneseve lidhur me kontrolle të shtuara në terren nga inspektorët tatimorë si edhe me shqetësimin se këto kontrolle penalizonin në një masë të konsiderueshme biznesin e vogël si pjesa më e pambrojtur.

8. Qeveria bëri disa herë me dije për publikun edhe në takimet e organizuara me bizneset se *fokusi i aksionit do të ishte bizneset e mëdha*, ndërsa kontrollet në terren për *biznesin e vogël kishin natyrë ndërgjegjësimi* lidhur me dosmodoshmërinë për të ushtruar aktivitet si subjekte të regjistruar rregullisht në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Theksi u vendos në detyrimin ligjor për ushtrimin e aktivitetit me pajisje fiskale dhe lëshimin e kuponit tatimor. Nga ana tjetër, fermerëve iu bë thirrje në vazhdimësi për t’u regjistruar dhe për t’u pajisur me NUIS në mënyrë që të mund të përfitonin nga skemat e rimbursimit të TVSH-së dhe nga grantet e projekteve të ndryshme nën asistencën e qeverisë.

9. Më 16 Nëntor 2015, Kryeministri

135/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”

prezantoi për biznesin e vogël disa nga masat e parashikuara në Paketën Fiskale (2016), duke parashtruar lehtësira në barrën fiskale. Për bizneset e vogla me xhiro vjetore nga 0-5 milionë ALL, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin do të ishte 0, ndërsa për bizneset me xhiro vjetore nga 5 milionë-8 milionë ALL, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin do të ishte 5%¹¹. Gjithashtu biznesit të vogël iu dha garanci për tërheqjen e inspektorëve tatimorë nga terreni dhe kryerjen e kontroll-ove tatimore mbi bazën e *Modelit të Riskut*.

10. Më 7 Dhjetor 2015 në një seancë dëgjimore të organizuar nga Komisioni Parlamentar i Ekonomisë dhe Financave, shoqatat e biznesit paraqitën sugjerimet dhe komentet e tyre lidhur me ndryshimet e parashikuara në Paketën Fiskale (2016)¹², por edhe të ligjeve të ndryshme në fushën e ekonomisë duke e vënë theksin kryesisht tek ulja e barrës fiskale.

11. Aksioni kundër informalitetit u mbështet në parim nga një sërë institucionesh dhe misionesh ndërkombëtare në Shqipëri, nga shoqatat e biznesit dhe ekspertët në fushën e ekonomisë duke e cilësuar si një iniciativë të domosdoshme për ekonominë shqiptare.

Ndërkohë, grupet e interesit u nxitën të shprehen lidhur me iniciativat e ndërmarra, si rezultat disa nga komentet më të spikatura të këtyre grupeve janë përmbledhur si më poshtë:

¹¹ Këto ndryshime, pjesë e projekt-ligjeve të Paketës Fiskale (2016), janë ende në proces legjislativ në Kuvendin e Shqipërisë.

¹² Paketa Fiskale (2016) u publikua zyrtarisht më 18 nëntor 2015 nga Ministria e Financave <http://www.financa.gov.al/al/legjislacioni/aktet-ligjore-dhe-nenligjore-per-taksat/paketa-fiskale->

» Ekspertë të ndryshëm në fushën e ekonomisë kanë theksuar domosdoshmërinë e incentivave për formalizim dhe përmirësim të administrimit fiskal si parakushte për zbatimin e penalteteve dhe gjobave ndaj biznesit.

» Referuar aksionit, në një deklaratë për shtyp (10 Shtator 2015), FIAA thekson se: “*Ky është një hap mëse i mirëpritur për ekonominë e vendit, i cili do të përmirësojë ndjeshëm mjedisin e biznesit me përfutime të dukshme për të gjithë popullsinë. Për më tepër, FIAA beson se një luftë efektive ndaj informalitetit është një nga mënyrat më të mira për të parandaluar një rritje të mëtejshme të taksave, e cila do të pengonte rritjen ekonomike*”¹³.

» Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë ka mbështetur aksionin ndaj informalitetit në parim, por duke shprehur rezervë lidhur me masat represive të ndërmarra nga Qeveria ndaj biznesit dhe ndaj ndryshimeve në Ligjin nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në RSH” për ashpërsimin e gjobave në fushën tatimore, ndryshime të cilat u kryen pa konsultim paraprak me biznesin¹⁴.

» Dhoma Amerikane e Tregtisë ka shprehur shqetësimin lidhur me aksionin e nisur nga qeveria kundër informalitetit duke dalë në përfundimin se ashpërsimet në procedurat tatimore kanë efekt të kundërt dhe i detyrojnë bizneset të falimentojnë.

» Dhoma Gjermane e Tregtisë ka mbështetur aksionin ndaj informalitetit, por duke

¹³ Këto deklarime u bënë edhe gjatë prezantimit më 6 tetor 2015 të Anketës “Business Environment”, kryer nga FIAA;

¹⁴ Ky qëndrim është mbajtur nga drejtuesi i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, z. Nikolin Jaka në media dhe forume të ndryshme përfshirë edhe mbledhjen e datës 5 tetor 2015 të Këshillit të Investimeve.

nënvizuar se “djalli fshihet në detaje”, ka nxjerrë në pah karakterin agresiv të aksionit dhe proporcionalitetin e masave ndëshkuese për evazionin tatimor në raport me dëmin e shkaktuar¹⁵.

» Konfindustria ka mbështetur aksionin parimisht duke propozuar hapa konkretë për uljen e shkallës së informalitetit në vend sikurse është ulja e barrës fiskale dhe liberalizimi i tregut të kasave fiskale.

» Avokati i Popullit ka nënvizuar se aksioni ndaj informalitetit duhet shoqëruar me politika sociale.

» Përfaqësuesi i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) në Shqipëri ka vlerësuar aksionin duke nënvizuar se: “*Nisma është e nxitur nga niveli i lartë i informalitetit, nga mungesa e të ardhurave dhe nga moshëtimi i ligjeve tatimore në masë të plotë. Në aspektin e përmbushjes së ligjeve tatimore, ne e mbështesim atë. Nuk kam pasur ndonjëherë përshtypjen se kjo është e fokusuar te biznesi i vogël në veçanti. Ajo që qeveria synon të arrijë është që të luftojë informalitetin kudo që shtrihet, në të gjitha transaksionet ekonomike*”¹⁶.

» Përfaqësuesja e Bankës Botërore në Shqipëri ka nënvizuar se: “*lufta kundër informalitetit duhet të jetë e vazhdueshme dhe se duhet të zbatohet ndershmërisht në të gjitha segmentet e ekonomisë dhe biznesit,*

¹⁵ <http://www.balkanweb.com/site/kasten-mbeshtesim-aksionin-ndaj-informalitetit-por-djalli-fshihet-ne-detaje/>

¹⁶ Burimi-Intervistë në Ora News 14 Tetor 2014

çka krijon besueshmëri në sytë e publikut, që reformat janë të ndershme dhe zbatimi i ligjit është i barabartë për të gjithë”. Gjithashtu sipas saj “*Qeveria do të duhet të sigurojë mekanizma të mjaftueshëm sociale për të adresuar pasojat apo çështjet afatshkurtra që mund të dalin mbi segmentet më të varfëra të shoqërisë*”¹⁷.

» Banka e Shqipërisë në një njoftim për shtyp ka mbështetur aksionin ndaj informalitetit duke vlerësuar faktin se: “*Lufta kundër informalitetit do të sjellë shmangien e dy standardeve në pasqyrat financiare dhe bilancet e kompanive. Formalizimi do të ndikojë dhe në zhvillimin e tregjeve të kapitaleve, ndërkohë që po konsideron efektet e aksionit*”¹⁸.

Pra, në mënyrë të përmbledhur mund të nënvizohet se diskutimet dhe debatet nga aktorë të ndryshëm janë fokusuar në lidhje me faktin nëse “masat e ndërmarra nga Qeveria janë ato të duhurat”, në lidhje me proporcionalitetin e tyre, formën dhe përmbajtjen, duke u konsideruar shpeshherë edhe si “represive” apo të kryera me “qëllim për të penalizuar biznesin”. Ndërkohë, që vërejmë se Qeveria ka ndërmarrë një sërë masash me synim krijimin e kushteve për një konkurrencë të ndershme. Pra, cilat mund të jenë arsyet e perceptimeve të mësipërme nga ana e aktorëve të ndryshëm?!

Burimi-<http://www.mapo.al/2015/09/bb-mbeshtesim-luften-kunder-informalitetit-kujdes-me-te-varferit>

¹⁸ Burimi http://www.bankofalbania.org/web/NJOFTIM_PER_SHTYP_7325_1.php

METODOLOGJIA

I. HULUMTIMI I DOKUMENTAVE

Për të bërë një analizë realiste por edhe krahasimore, Sekretariati ka konsideruar edhe një sërë studimesh akademike mbi informalitetin, matjet e tij, ndikimin në ekonomi dhe trajtimin e fenomenit. Si të tilla janë studiuar reformat më të mira ndaj informalitetit të kryera nga qeveritë e vendeve të BE-së (Itali dhe Sllovaki), Turqisë, Moldavisë, Gjeorgjisë dhe rajonit (Maqedoni) etj., si edhe studime të OECD, FMN, Bankës Botërore, IFC, BERZH. Janë organizuar intervista me aktorë të ndryshëm të biznesit, si edhe një konsultim i hapur dhe gjithëpërfshirës me përfaqësues të 14 dhomave të tregtisë dhe shoqatave të biznesit¹⁹. Gjithashtu për trajtimin e informalitetit në kontekstin shqiptar është bërë një kërkim në dokumentat kryesore zyrtare të publikuara dhe të miratuara nga Qeveria Shqiptare me fokus luftën ndaj ekonomisë informale. Renditja e tyre është kryer si më poshtë në rendin kronologjik:

19 <https://www.investment.com.al/sq/per-nje-reforme-efikase-kunder-informalitetit/>

AKTET DHE DOKUMENTAT E MIRATURA DHE TË PUBLIKUARA

1. Në fund të vitit 2003, Ministria e Ekonomisë i kërkoi OECD Investment Compact të kryente një studim mbi ekonominë informale në vend me qëllim identifikimin e rekomandimeve të nevojshme për reduktimin e ekonomisë informale. Deri më sot, ky është studimi më i plotë i kryer lidhur me informalitetin në ekonominë shqiptare. Studimi u krye duke përdorur një kombinim të statistikave, makro dhe mikroekonomike dhe mori në konsideratë madhësinë dhe intensitetin e aktiviteteve informale në sektorin e shoqërive tregtare, ndikimin e regjimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore, si edhe lidhjen që ekziston midis ekonomisë informale dhe përhapjes së konkurrencës së pandershme. Në përputhje me gjetjet dhe rekomandimet e këtij studimi, Qeveria Shqiptare ngriti një Komitet për përgatitjen, hartimin dhe

zbatimin e një plani veprimi për reduktimin e ekonomisë informale²⁰.

2. Ky Komitet përgatiti në dhjetor 2004 një Plan Veprimi të detajuar për reduktimin e ekonomisë informale. Plani i Veprimit identifikonte objektivat që synoheshin, masat që do të zbatoheshin sipas afateve kohore konkrete, institucionet përgjegjëse dhe treguesit e monitorimit. Plani i Veprimit parashikonte zbatimin e masave në periudhën kohore 2005-2009 dhe u miratua në Prill të vitit 2005²¹.

3. Pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2005, Qeveria shqiptare miratoi një plan veprimi të reformës rregullatore në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit duke e argumentuar këtë me faktin *se kuadri rregullator jo cilësor në fuqi deri në atë kohë ka nxitur një shkallë të lartë informaliteti në ekonominë shqiptare*²².

4. Plani i Veprimit për Reduktimin e Ekonomisë Informale u rishikua sërish për periudhën 2006-2009²³, por duke u mbështetur në të njëjtat shtylla kryesore si: 1) përmirësimi dhe rregullimi i vlerësimeve statistikore dhe të PBB-së; 2) Identifikimi dhe mbledhja e saktë e kontributeve shoqërore; 3) Përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe lehtësimi i procedurave për hapjen dhe zhvillimin e tij.

5. Nga viti 2014 e në vijim janë miratuar një sërë dokumentash të tjerë me impact edhe në reduktimin e informalitetit në

20 Urdhër Nr. 180 datë 11.11.2004 i Kryeministrit "Për ngritjen e Komitetit për Hartimin dhe Zbatimin e një Plani Veprimi për Reduktimin e Ekonomisë Informale"

21 VKM Nr. 246, datë 21.04.2005

22 VKM Nr. 157, datë 15.03.2006

23 VKM Nr. 430 datë 28.06.2006

ekonomi, si:

- a. Programi Ekonomik dhe Fiskal i Shqipërisë për periudhën 2014-2016²⁴ në të cilën evidentohen drejtimet kryesore të luftës kundër informalitetit:
 - » Rritja e inspektimeve nga Inspektorati Shtetëror i Punës (ISHP);
 - » Rritja e kontrolleve nga Njësia e Zbatimi të Task Forcës në Drejtorinë e Hetimit Tatimor;
 - » Rritja e përdorimit të pajisjeve fiskale.
- b. Plani i veprimit për përmirësimin dhe monitorimin e indikatorëve *"Doing Business 2015"*²⁵;
- c. Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 - 2020 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e saj²⁶ e cila evidenton problematikat e informalitetit në këndvështrimin e çështjeve të punësimit.
- d. Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2014 - 2020²⁷ e cila pavarësisht se nuk lidhet drejtpërsëdrejti me informalitetin në ekonomi, ka objektiv garantimin e një sistemi të financave publike që nxit transparencën, përgjegjshmërinë, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe zhvillimin ekonomik.

24 VKM Nr. 33 datë 29.01.2014

25 VKM Nr. 591 datë 10.09.2014

26 VKM Nr. 818 datë 26.11.2014

27 Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike-Ministria e Financave

2. TAKIME INDIVIDUALE

Gjatë periudhës Tetor-Nëntor 2015 nga ana e Sekretariatit janë kryer një numër i konsiderueshëm takimesh me aktorë të ndryshëm të përfshirë në diskutimet mbi aksionin kundër informalitetit si shoqëri tregtare, shoqata dhe organizata biznesesh, aktorë të shoqërisë civile, ekspertë të pavarur të ekonomisë, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe zyrtarë të administratës fiskale, etj. Qëllimi i takimeve ka qenë mbledhja e sa më shumë mendime mbi aksionin, shkaqet e informalitetit dhe sugjerimeve për trajtimin me efektivitet të fenomenit.

3. ANKETA ONLINE

Gjithashtu, një anketë anonime mbi informalitetin u përgatit nga Sekretariati dhe u lançua në faqen e Këshillit të Investimeve (KI) për të marrë opinione të drejtpërdrejta nga biznesi. Anketa u plotësua nga 89 biznese online dhe 11 kompani në takime direkte. Rreth 60% e firmave të anketuara ishin me xhiro mbi 8 milion ALL dhe përkatësisht 73% subjekt i TVSH-së dhe 20% biznese të klasifikuara si VIP nga Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj. Bizneset e huaja përfaqësonin rreth 30% të përgjigjeve. Sektorët më të përfaqësuar në anketë ishin shër-

bimet (36%), tregtia (33%), industria (29%). Pyetjet e anketës u fokusuan në përfitimet dhe kostot e formalizimit, evidentimin e shkaqeve që çojnë në informalitet dhe masat që bizneset mendojnë se duhet të zbatohen për të nxitur dhe lehtësuar formalizimin e ekonomisë shqiptare.

4. RAST STUDIMOR – SEKTORI I QUMËSHTIT

Për të evidentuar problemet në një dimension sektorial dhe konkret, analiza u shoqërua edhe me një studim paraprak të informalitetit në sektorin e përpunimit të qumështit. Qëllimi ishte kryerja e një studimi më të fokusuar nga ana sektoriale për të evidentuar më konkretisht problemet, me qëllim dhënien e rekomandimeve sa më realiste për një reformë të suksesshme. Gjetjet e pasqyruara u bazuan në problemet e ngritura gjatë diskutimeve me rreth 200 aktorë të sektorit, kryesisht prodhues të qumështit nga rajoni i Fierit, Beratit dhe Vlorës, Shoqata e Përpunuesve të Qumështit dhe të Mishit (ADAMA), si dhe përfaqësuesit e baxhove më të mëdha në vend, dhe përpunuesit individualë në zonat e Përmetit, Fierit dhe Vlorës. Studimi sektorial mori në shqyrtim të gjithë zinxhirin e vlerave me të gjithë aktorët dhe operacionet formale/informale në prodhim, shpërndarje dhe punësim.

ANALIZA E INFORMALITETIT NË SHQIPËRI

I. PIKËNISJA E ANALIZËS

Studime të organizatave ndërkombëtare kanë treguar se Shqipëria ka një shkallë të konsiderueshme të informalitetit në ekonomi. Anketat e BERZH dhe Grupit të Bankës Botërore me Ndërmarrjet (BEEPS V) ka evidentuar se 40,2% e firmave të anketuara raportojnë konkurrencë nga sektori informal veçanërisht kjo e ndjeshme në sipërmarrjet e vogla dhe të mesme. Studimi i Schneider (2010) ka vlerësuar ekonominë informale në Shqipëri për periudhën 1999-2007 në mesatarisht 34,3% të PBB-së. Një studim më i fundit i Boka dhe Torluccio (2013) ka llogaritur se ekonomia informale për periudhën 1996 – 2012, në varësi të metodës së përdorur, vlerësohet mesatarisht nga 13,6% në 38% të PBB-së. *Sipas Qeverisë Shqiptare niveli i informalitetit në ekonomi vlerësohet të jetë mbi 50%.*

Informaliteti nuk është një fenomen që ndeshet vetëm në Shqipëri apo vende në tranzicion. Schneider (2010) ka bërë llogaritjet për 27 vendet e BE për nivelin e ekonomisë informale për periudhën 2003 - 2012 duke konkluduar se Bullgaria ka shkallën më të lartë të informalitetit në 30,1% të PBB-së në 2012 dhe Austria shkallën më të ulët në 7,6% të PBB-së, ndërkohë mesatarja europiane

në po këtë vit llogaritet në 18,2% të PBB-së. Informacion më i detajuar lidhur me informalitetin në vendet e BE-së pasqyrohet në Aneksin 1. Shumë qasje në trajtimin e informalitetit përqëndrohen tek sipërmarrjet dhe përpiqen të identifikojnë kriteret që dallojnë sipërmarrjet e formalizuara nga sipërmarrjet informale. Disa nga treguesit kryesorë²⁸ që mbahen parasysh për të identifikuar sipërmarrjet informale kanë të bëjnë me: madhësinë; statusin e regjistrimit apo njohjes së sipërmarrjes nga një agjenci qeveritare; punëdhënësi/kontributet e sigurimeve shoqërore të paguara nga sipërmarrja; forma ligjore e organizimit të sipërmarrjes dhe natyra e llogarive financiare; të drejtat ligjore dhe ato të pronësisë.

Sidoqoftë, një analizë e plotë e faktorëve që nxisin informalitetin kërkon thellim dhe një vështrim të gjithanshëm ligjor dhe institucional mbi mangësitë që mund të lënë hapësira ose nxisin informalitetin, si p.sh. legjislacioni i punës, çështjet e pronësisë, regjistrimit dhe licencimit të aktiviteteve private, tregut financiar, barra fiskale


28 "Informality, Inclusiveness, and Economic Growth: An Overview of Key Issues" - James Heintz University of Massachusetts, Amherst, USA Political Economy Research Institute- July 2012.

dhe sistemi tatimor, etj. Në fakt ky punim nuk pretendon të ezaurojë të gjitha problematikat mbi shkaqet dhe masat për trajtimin e informalitetit. Ai synon të nxisë debatin duke strukturuar reagimet ndaj veprimeve të ndërmarra nga Qeveria dhe të prioritzojë rekomandimet konkrete të gjeneruara nga biznesi me synim përmirësimin e klimës së biznesit.

Në përgjithësi, mund të themi se vihet re një ndërgjegjësim dhe mirëkuptim nga të gjithë aktorët për domosdoshmërinë dhe përfitimet që mund të gjenerojë në afat të gjatë formalizimi i ekonomisë. Rreth 80% e bizneseve të përgjigjura në anketë konfirmojnë se ndeshen me konkurrencë të pandershme si pasojë e informalitetit. Po sipas rezultateve të anketës pjesa më e madhe e bizneseve (rreth 60%) e konsiderojnë më shumë kosto se përfitim të qenit informal. Megjithatë, përfitimet nga të qenit informal shikohen më shumë në afat

të shkurtër—nxitur nga konteksti aktual ligjor dhe administrativ, ndërsa pranohet se ka më shumë kosto që lidhen me pagesat nën dorë, sigurinë e biznesit dhe frikën nga kontrollet tatimore. Sipas një studimi të ILO²⁹ (2011) mbi punësimin informal, arsyet për informalitetin në Shqipëri lidhen si me legjislacionin e komplikuar dhe rregullimet administrative, barrën fiskale, mungesën e besimit tek institucionet, ashtu edhe me kulturën dhe etikën për të paguar taksat si dhe pranimin gjerësisht nga publiku të punës ilegale. Shkalla e informalitet është refleksion edhe i modelit të zhvillimit ekonomik të vendit. Ekonomia shqiptare është një ekonomi e bazuar kryesisht në shërbime dhe bujqësi, ku sektori bujqësor ka një kontribut shumë të ndjeshëm në krahasim me vendet e rajonit në Produktin e Brendshëm Bruto, por nga ana tjetër ka edhe produktivitetin më të ulët në rajon (Figura 1).

Figura 1. Kontributi i Sektorëve në Produktin e Brendshëm Bruto për 2006-2014



Burimi: Të dhëna të Bankës Botërore


29 "Një studim krahasues mbi punësimin informal në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Moldavi dhe Mal i Zi" – ILO, 2011.

Kontributi i bujqësisë me rreth 22% të PBB-së për 2014 është akoma më i ndjeshëm në punësim ku mesatarisht 50% e fuqisë punëtore për 2012

- 2015 deklarohet e vetëpunësuar në këtë sektor sipas statistikave zyrtare të INSTAT³⁰ (Figura 2).

30 Anketa e Forcës së Punës, T-2 2015, INSTAT.

Figura 2. Të vetëpunësuarit në sektorin privat bujqësor




Burimi: INSTAT

Po sipas INSTAT për vitin 2014, vetëm 13% e aktiviteteve ekonomike të regjistruara i përkasin bujqësisë, ndërsa peshën më të madhe të numrit të ndërmarrjeve e mban tregtia (47%) me numrin edhe më të lartë të personave fizikë (27% të totalit të të regjistruarve). Mendohet se sektorët

që paraqesin më shumë informalitet janë tregtia, shërbimet dhe bujqësia. Të dhënat fiskale, tregojnë se pesha e sektorit publik ndaj PBB-së është në nivelet më të ulëta në rajon, e krahasueshme me Kosovën, në 25%-26% të PBB-së për periudhën 2000 – 2015 (Figura 3).

Figura 3. Të ardhurat qeveritare ndaj PBB-së për vendet e Ballkanit Perëndimor 2000 – 2015



Burimi: FMN, WEO (tetor 2015)

Burimi kryesor i të ardhurave qeveritare mbeten të ardhurat tatimore dhe doganore ku veçanërisht i dukshëm është kontributi i TVSH-së, i nd-

jekur nga sigurimet shoqërore dhe akciza siç tregohet në Tabelën 1 më poshtë me të dhëna që nga viti 2005.

Tabela 1. Peshë e të ardhurave nga taksat ndaj totalit të të ardhurave tatimore

TAKSAT	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	9-mujor 2015
Nga tatimet dhe doganat	74%	75%	77%	78%	77%	77%	77%	77%	76%	75%	75%
TVSH	35%	36%	38%	41%	41%	40%	39%	39%	37%	37%	36%
Tatimi mbi fitimin	10%	11%	9%	7%	6%	6%	6%	6%	5%	6%	7%
Akcizat	10%	11%	13%	12%	12%	13%	13%	12%	13%	12%	12%
TAP	4%	4%	7%	9%	10%	9%	9%	9%	10%	9%	9%
Sigurimi shoqëror	18%	17%	16%	16%	16%	16%	16%	16%	17%	18%	17%
Sigurimi shëndetësor	2%	2%	2%	2%	2%	2%	2%	2%	2%	2%	3%

Burimi: Ministria e Financave (tetor 2015)

Referuar studimit të IFC (2013)³¹ kosto e përm-bushjes së detyrimeve tatimore paraqet një peshë më të rëndë për firmat më të vogla, duke përbërë 4,7% të totalit të të ardhurave për kompanitë mikro, 3,9% për kompanitë e vogla, 1,4% për kompanitë mesatare dhe 0,3% për kompanitë e mëdha. Raporti i Bankës Botërore “*Doing Business 2016*” ka konkluduar se “*Shqipëria renditet e 142-ta në treguesin e Pagimit të Taksave dhe një firmë duhet të bëjë mesatarisht 34 pagesa taksash në vit dhe të harxhojë 357 orë për përgatitje, plotësim dhe pagesa duke paguar një shumë totale taksash të barabartë me 36,5% të fitimit*”.

Sikurse u tha me lart, informaliteti ka një natyrë dhe shfaqje komplekse dhe trajtimi i tij kërkon një këndvështrim disa planesh të cilat lidhen në thelb edhe me klimën e biznesit. Ky dokument ka evidentuar vetëm disa nga shkaqet më të përmendura në intervistat, diskutimet me palet

31 Tax Compliance Cost in Albania IFC- IDRA (2013)




Figura 4. Faktorët më problematikë për të bërë biznes sipas anketës

Burimi: Përpunim i autorëve nga përgjigjet e Anketës

e interesuara dhe përgjigjet e anketës si edhe të ndeshura në praktikat ndërkombëtare.

Bazuar në sa më sipër, **Sekretariati ka identifikuar se në rastin e Shqipërisë faktorët konkretë që nxisin informalitetin lidhen me: (i) sistemin tatimor, (ii) cilësinë e institucioneve, (iii) aksesin në financim dhe (iv) masat ndëshkimore.**

2. GJETJET E ANALIZËS


Referuar rezultateve të anketës, takimeve dhe tryezës me përfaqësues të biznesit është arritur të konkludohet në një seri shkaqesh që shikohen si nxitës të informalitetit, por nëse këto tregues përmirësohen, mund të kthehen njëkohësisht në frenues të fenomenit dhe kontribues në klimën e të bërit biznesit. Nga përgjigjet në anketë, bizneset shprehen se ndeshin vështirësi më të mëdha në lidhje me sistemin tatimor (numrin e taksave, barrën fiskale dhe procedurat tatimore) si dhe për sa i përket aksesit në kreditim (Figura 4).

3. SISTEMI TATIMOR

Sistemi tatimor përbën një nga shtyllat kryesore që lehtëson ose vështirëson formalizimin e ekonomisë, por edhe bën ose jo më atraktive klimën e biznesit. Në këndvështrimin e sistemit tatimor nga biznesi janë identifikuar si shqetësime: barra tatimore, fragmentizimi i sistemit tatimor, administrata tatimore dhe procedurat tatimore.

Administrimi i taksave shprehet si problematik edhe në raporte të ndryshme të organizatave ndërkombëtare për klimën e biznesit në Shqipëri në këto vitet e fundit, por njëkohësisht është një shqetësim i hapur i biznesit nga takimet direkte dhe përgjigjet e mbërritura nëpërmjet anketës online. Komente të shumëllojshme, në përgjithësi negative, mbi kapacitet e administratës, interpretimin e legjislacionit, kontrollet e shpeshta tatimore janë nënvizuar në vazhdimësi nga biznesi. Këto komente vazhdojnë të jenë në koherencë edhe me gjetjet dhe rekomandimet e Dokumentit të Punës së Sekretariatit *“Propozime për Përmirësimin e Procesit të Kontrollit Tatimor: Analizë në kuadër të Përmirësimit të Klimës së Biznesit në Shqipëri”* të prezantuar në Mbledhjen e KI të datës 5 tetor 2015, ku konkretisht janë evidentuar TVSH-ja, paqartësia dhe ndryshimet e shpeshta të legjislacionit tatimor, si dhe marrëdhëniet me Administratën Tatimore, si faktorët që mund të çojnë në informalitet (Figura 5).

Figura 5. Opinionet e biznesit mbi faktorët kryesorë që çojnë në informalitet në lidhje me Sistemin Tatimor



Burimi: Anketa e Kontrollit Tatimor: Përpunim i Sekretariatit (shtator - tetor 2015)

Bizneset shprehin gjithashtu shqetësime lidhur me procedurat e njohjes së shpenzimeve të tyre (si p.sh. njohja e firove) nga ana e administratës tatimore dhe mungesa e kapaciteteve të kësaj të fundit për të kuptuar procese të caktuara teknologjike. Bizneset si dhe ekspertët fiskalë kanë reagime të shumta në lidhje me politikën aktuale fiskale të fragmentizuar që shikohet si shtysë për informalitet, ndërsa nënvizohet prezenca e një administrate tatimore jo profesionale që nuk i përgjigjet intensitetit dhe profesionalizmit që kërkon reforma kundër informalitetit. Ndonëse hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë kohët e fundit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, sikurse është zbatimi i *Modelit të Riskut*

apo kryerja e trajnimeve intensive të administratës tatimore, mendojmë se ka vend për ndryshimin e qasjes së marrëdhënies administratë tatimore - biznes. *Krijimi i një klime mirëkuptimi dhe zhvillimi i dy-kahshëm do të synonte që kontrolli i parë nga tatimorët tek biznesi të ishte konsultativ dhe në rast të mos zbatimit të udhëzimeve të lëna nga tatimorët, kontrolli i dytë të vijonte me zbatimin e penaliteteve të ashpra.* Kjo do të shmangte konfuzionin, keqinterpretimet dhe abuzimet nga të dyja palët. Sipas përgjigjeve direkte në anketë, korrupsioni në administratë nxit informalitetin dhe mospagimin e taksave.

Më konkretisht çështjet e evidentuara janë paraqitur si më poshtë:

a) Fragmentizimi i sistemit tatimor

» *Pragu i TVSH-së* në xhiron 5 milionë lekë për biznesin e vogël bën që zinxhiri i TVSH-së të thyhet dhe të mos mundësohet lidhja deri tek konsumatori final, tek i cili duhet të shkarkohet kjo taksë indirekte. Megjithëse është konsideruar si një masë mbështetëse për zhvillimin e biznesit të vogël, por edhe faktor në uljen e çmimeve për konsumatorët, për një pjesë të konsiderueshme të ekspertëve dhe bizneseve shikohet si një nxitës drejt informalitetit dhe evazionit fiskal. Vlerësohet e padrejtë ndërprerja e zinxhirit të TVSH-së që shmang kontrollin e xhiros reale të bizneseve, mundësinë e kryqëzimit të faturave me TVSH dhe verifikimin e inventareve dhe shitje-blerjeve të mallrave të ndërmjetëm. Ndërkohë ka një presion nga bizneset që e konsiderojnë veten të vegjël për të mos marrë faturë me TVSH nga shitësit me shumicë dhe furnitorët për të shmangur kontrollin dhe ruajturi xhiron e deklaruar nën pragun e TVSH-së.

» *Ndarja e normës së tatimit fitimit sipas xhiros në biznesin e vogël dhe të madh.* Qeveria me paketën e re fiskale të 2016 ka parashikuar si incentivë për biznesin e vogël në kuadër të masave kundër informalitetit, heqjen e tatimit mbi fitimin për bizneset deri në 5 milion ALL xhiro dhe uljen në 5% të tatimit mbi fitimin për fashën nga 5 - 8 milion ALL xhiro. Sërish, kalimi nga një normë fitimi të biznesit të vogël nga 0% në 5% dhe më tej në 15% konsiderohet si një shkak për të mbajtur xhiron vjetore poshtë nivelit të 5 milion apo 8 milionë ALL.

Çmimet e referencës në dogana dhe tarifat doganore për importet nga vendet jashtë BE-së, si p.sh. nga Kina, shpesh janë shkak për kontrabandë, evazion por edhe abuzim në fshehjen apo mbivlerësim të kostos reale të blerjes së produkteve. Ndërkohë që tarifat e ulëta doganore në rajon nxisin hyrjen e mallrave ilegalisht si mallra konsumi vetjak dhe konkurrencën e pandershme në tregje.

b) Pajisjet fiskale

» Ka një perceptim se aksioni i Qeverisë është i përqëndruar në pajisjen me kasë fiskale, lëshimin dhe marrjen e kuponit tatimor. Pajisja me kasë vlerësohet si një mjet i rëndësishëm për shmangien e evazionit fiskal. Megjithatë, ka diskutime për përballimin e çmimit të lartë të kasave fiskale, veçanërisht nga biznesi i vogël, si dhe asistencën e kompanive të kasave fiskale për proceset e mirëmbajtjes së kasave në kohë. Gjithashtu evidentohet që administrata tatimore nuk unifikon praktikën mbi rastet kur edhe pse sipas legjislacionit nuk është e nevojshme pajisja me kasa fiskale, sërish bizneset detyrohen të pajisen me to nga frika e penaliteteve.

Motivimi i bizneseve për të përdorur sa më shumë kanalet bankare për transaksionet e biznesit edhe për bizneset e vogla duhet inkurajuar, pasi kuadri ligjor nuk detyron pajisjen me kasë fiskale në rastin kur biznesi kryen arkëtime në rrugë bankare. Më poshtë paraqitet një analizë ligjore për raste të tilla, përgatitur nga Sekretariati dhe dërguar Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

ANALIZË LIGJORE MBI DETYRIMIN PËR PAJISJEN ME KASË FISKALË

Biznese dhe individë të regjistruar rregullisht në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si subjekte tregtare ose persona fizikë, për shkak të aktivitetit të tyre tregtar të kufizuar nuk kryejnë pagesa me para në dorë për qarkullimin e mallrave apo shërbimeve të tyre. Këto pagesa kryhen rregullisht nëpërmjet bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë, duke dokumentuar kështu të gjitha arkëtimet dhe/ose pagesat e tyre.

Në këto kushte këto biznese lëshojnë fatura të rregullta tatimore (format TVSH ose faturë e thjeshtë tatimore), por nuk kanë instaluar pajisje fiskale, në përputhje me parashikimet e Nenit 55 të Ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008 (i ndryshuar), i cili parashikon rregullin e përgjithshëm në paragrafin 1 si vijon: ***“Tatimpaguesit, që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, janë të detyruar të instalojnë dhe të përdorin sistemin fiskal, nëpërmjet përdorimit të pajis-***

jeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe për lëshimin, në mënyrë të detyrueshme, të kuponit tatimor...” dhe në vijim të detajimeve ligjore të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore” (i ndryshuar).

Pavarësisht nga sa më sipër parashikuar në dispozitat ligjore, gjatë kontrolleve të kryera nga ana e administratës tatimore në terren dhe nga interpretimet që po japin Drejtoritë Rajonale Tatimore lidhur me këtë problematikë, këtyre bizneseve iu kërkohej domosdoshmërisht instalimi i pajisjeve fiskale edhe pse nuk kryejnë asnjë arkëtim me para në dorë. Si justifikim për këtë kërkesë, këtyre bizneseve ju argumentohet se lloji i aktivitetit të ushtruar nuk është i përjashtuar nga detyrimi i lëshimit të kuponit tatimor sipas përcaktimeve të VKM nr.781 datë 14.11.2007 “Për Karakteristikat Teknike e Funksionale të Pajisjeve Fiskale” paragrafi 1 pika 9.2.3 dhe paragrafi III.

Sipas Sekretariatit të Këshillit të Investimeve dhe jo vetëm, këto interpretime vijnë ndesh në gërmë dhe me frymën e Ligjit nr. 9920 dhe Udhëzimit nr. 24 dhe krijojnë paqartësi tek tatimpaguesit. Në analizën e Sekretariatit, ***tatimpaguesit të cilët nuk kryejnë arkëtime me para në dorë, por i realizojnë këto pagesa vetëm nëpërmjet bankës nuk kanë detyrimin e instalimit të pajisjeve fiskale***. Nëse do të ishte ndryshe, legjislatori nuk do të parashikonte shprehimisht në Nenin 55 togfjalëshin ***“për pagesat që nuk kryhen nëpërmjet bankës”***.

4. CILËSIA E INSTITUCIONEVE

Bizneset shfaqin një mungesë besimi ndaj institucioneve publike në përgjithësi dhe atyre të administrimit fiskal në veçanti. Si faktorë që kanë gjeneruar shkakllën e lartë të informalitetit konsiderohen korrupsioni dhe ndikimi politik. Ndërkohë shprehen shqetësime për kontrabandën e mallrave që importohen, por edhe mungesën e kapaciteteve dhe standartizimeve për kontrollin e prodhimit vendas. Në mënyrë të përmblodhur disa nga problematikat kryesore janë:

a. Kapacitetet e administratës publike

» Është një shqetësim i vazhdueshëm i bizneseve aftësia e administratës publike, në veçanti e administratës tatimore, për t'iu përgjigjur intensitetit të aksionit kundër informalitetit. Mungesa e besimit dhe reagimet jo pozitive mbi cilësinë e administratës janë të dukshme në përgjigjet e anketës, por edhe nga intervistat direkte me sektorin privat. Referuar edhe Punimit të Sekretariatit mbi *Kontrollin Tatimor*, kapacitetet e administratës shikohen të kufizuara në disa aspekte, si infrastruktura administrative, komunikimi dhe profesionalizmi. Bizneset shprehen se inspektorët si tatimorë dhe doganorë nuk janë të specializuar sipas natyrës së biznesit për të dhënë gjykim të drejtë duke çuar në konflikte, penalitete dhe kosto për ta. Ndaj, bizneset kërkojnë një frymë bashkëpunimi dhe partneriteti me administratën publike.

b. Ngarkesa e lartë me inspektime

» Nga bizneset e kontaktura është raportuar një numër i madh kontrollesh nga institucione të ndryshme të administratës duke përfshirë administratën tatimore është raportuar nga bizneset e kontaktura. Vihet re një

mos-koordinim i inspektorateve shtetërore me njëri-tjetrin, gjë që krijon një tryzni negative mbi biznesin, paqartësi për objektin e kontrollit dhe arsyen përse tatimpaguesi është subjekt i kontrollit.

c. Barra administrative në licenca dhe procedura si për agro-industrinë e të tjera

» Në anketë ka komente në lidhje me numrin e lartë të licencave dhe institucioneve të përfshira për kontroll për një biznes prodhues në agro-industri, si p.sh., prodhimin e verërave ku shprehimisht deklarohet se duhen 4 licenca nga institucione të ndryshme, garanci bankare për 30% të produkteve, pagesa për pulla fiskale, pa llogaritur taksat, etj.

d. Mundësia reale për të kontrolluar bizneset prodhuese në vend

» Bizneset shprehen se prodhimi vendas si në agro-industri, por edhe sektorë të tjerë si ai i veshjeve krijon premisa për evazion pasi është e vështirë për administratën tatimore të kontrollojë sasinë e prodhimit. Kjo çon në një konkurrencë të pandershme në treg dhe krijon dyshime edhe për cilësinë e produkteve që i ofrohen konsumatorit.

e. Mungesa e konsultimit paraprak të legjislacionit dhe gjithëpërfshirjes

» Në bazë të parashikimeve të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, procesi i njoftimit dhe konsultimit publik dhe paraprak të projektligjeve, projekt dokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik është i detyrueshëm. Organet ekzekutive që propozojnë iniciativat ligjore

duhet të përmbushin detyrimet lidhur me dhënien e informacionit në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projekt-aktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri tek miratimi i aktit përfundimtar. Pavarësisht sa më sipër, shpesh ndryshimet ligjore njoftohen vetëm pasi projekt-ligjet miratohen nga Këshilli i Ministrave dhe kur këto projekt-ligje përcillen për miratim në Kuvendin e Shqipërisë. Një rast konkret i mos-konsultimit me publikun si edhe me grupet e interesit, përfshirë edhe shoqatat e biznesit, ishte miratimi i Ligjit nr. 99/2015 datë 23.09.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë (RSh)” të ndryshuar” (“Ligji Nr. 99/2015 datë 23.09.2015”). Miratimi i këtij ligji, i cili ashpërsoi sanksionet ndaj biznesit për shkelje në fushën tatimore, u shoqërua me debate lidhur me mungesën e transparencës së nevojshme dhe shkaktoi reagime nga komuniteti i gjerë i biznesit sikurse u përmend edhe më sipër.

f. Paqartësi të biznesit si rezultat i ndryshimeve ligjore të njëpasnjëshme dhe jo cilësore

» Sikurse është evidentuar edhe në Dokumentin e Punës “Propozime për Përmirësimin e Procesit të Kontrollit Tatimor: Analizë në kuadër të Përmirësimit të Klimës së Biznesit në Shqipëri” - *Ndryshimet shpeshta në kuadrin ligjor tatimor nuk i ndihmojnë bizneset në konsolidimin e qasjes së tyre të saktë ndaj sistemit tatimor. Ndryshimet e shpeshta në legjislacion janë një çështje tjetër e ngritur, e cila përmben*

*rrezik për stabilitetin e mjedisit të biznesit*³². Në kushtet kur legjislacioni tatimor, veçanërisht ai i cili lidhet me procedurat tatimore, është objekt i ndryshimeve të njëpasnjëshme dhe kur kapacitetet e administratës tatimore për të përthithur këto ndryshime dhe për të qenë të përditësuar mbeten të dyshimta, rreziku për arbitraritet në terren nga interpretimet e gabuara të ligjit dhe procedurave që ai përcakton është shumë i lartë, nxit pasiguri tek bizneset dhe mosbesim të ndërsjellë. Duke konsideruar gjithashtu mungesën e theksuar të njohurive në fushën tatimore dhe atë financiare³³ të tatimpaguesve, veçanërisht sa i përket biznesit të vogël, ndryshimet e shpeshta ligjore jo vetëm që nuk përmirësojnë situatën, por mund të sjellin efektin e kundërt pavarësisht qëllimit të tyre pozitiv. Nga ana tjetër, ndryshimet e nxituara, të pakonsultura dhe joharmonike prodhojnë konfuzion dhe norma juridike kontradiktore. Gjithashtu është shumë e nevojshme që legjislacioni sekondar-udhëzimet në fushën tatimore të jenë të detajuara me shembuj dhe raste konkrete për të gjitha normat dhe procedurat e parashikuara nga ligji dhe jo vetëm të referojnë fjalë për fjalë parashikimet e këtij të fundit.

PAQARTËSI NË LEGJISLACION MBI AFATET E PAGESAVE TË KËSTEVE TË TATIMIT TË THJESHTUAR MBI FITIMIN

Parashikimi i Nenit 13 i Ligjit nr. 99/2015 datë 23.09.2015 krijon paqartësi sa i përket afateve brenda të cilave tatimpaguesi duhet të parapaguajë këstet e tatimit mbi

³² Ligji Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” është ndryshuar gjithsej 12 herë.

³³ Sipas raportit të Standard & Poors 2015: “Shqipëria e parafundit në botë për njohuritë financiare”.

fitimin dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, me parashikimet e Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar) (“**Ligji Nr.9632**”). Me Nenin 13 të Ligjit nr. 99/2015 bëhet një shtesë në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008. Shtohet Neni 114/1 “*Mospagimi i kësteve të tatimit mbi fitimin dhe tatimi i thjeshtuar mbi fitimin*” me këtë përmbajtje: “...Mospagimi në afat i kësteve paraprake të tatimit mbi fitimin ose kësteve paraprake të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, sipas Nenit 30 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, dënohet me gjobë në masën 15 për qind të shumës së këstit për t’u paguar”. Neni 13 i lidh afatet e parapagimit me parashikimin e Nenit 30 “Parapagimet” të Ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” (“**Ligji Nr. 8438**”). Në Nenin 30 të Ligjit Nr. 8438 parashikohet: “*Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore, këstet tremujore të tatimit mbi fitimin, brenda datës 30 mars, për muajt janar, shkurt dhe mars; brenda datës 30 qershor, për muajt prill, maj dhe qershor; brenda datës 30 shtator, për muajt korrik, gusht dhe shtator dhe, brenda datës 30 dhjetor, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor*”. Neni 30 i ligjit nr. 8438 parashikon afatet e parapagimit të kësteve të tatimit fitimit, dhe jo afatet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar të fitimit (7,5%) i cili rregullohet me ligj të veçantë, dhe konkretisht me Ligjin nr. 9632. Në Nenin 15 të Ligjit nr. 9632 parashikohet midis të tjerash se: “*Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore ose Postës Shqiptare, këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin të biznesit të vogël, brenda datës 20 prill, për muajt janar,*

shkurt dhe mars; brenda datës 20 korrik, për muajt prill, maj dhe qershor; brenda datës 20 tetor, për muajt korrik, gusht dhe shtator dhe brenda datës 20 dhjetor, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor”.

Prandaj për sa më sipër, përmbajtja e Nenit 114/1 në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 e bërë me Nenin 13 të Ligjit nr. 99/2015 datë 23.09.2015 vjen në kundërshtim me parashikimin e Nenit 15 të Ligjit nr. 9632.


Kjo paqartësi lidhur me afatet do të krijojë probleme në zbatimin e detyrimit dhe të normës juridike, si tek tatimpaguesit ashtu edhe tek administrata tatimore dhe do të krijojë konflikt, aq më tepër që sanksioni i parashikuar për moskrerjen në kohë të pagesës së tatimit të thjeshtuar të fitimit është ***gjobë në masën 15 për qind të shumës së këstit për t’u paguar***. Paqartësia thellohet më tej kur i njëjti nen i ndryshuar është vendosur dhe reflektuar në pikën 14 të Vendimit nr. 31 datë 27.11.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhezimin Nr. 24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSh”, të ndryshuar. Jemi të mendimit se afatet për parapagimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin janë ato të parashikuara nga Neni 30 i Ligjit nr. 9632, i cili është një ligj specifik, parashikimet e të cilit nga pikëpamja e teknikës ligjvënëse nuk mund të ndryshohen tërthorazi me një ligj i cili nuk ndryshon ligjin specifik, por një ligj tjetër, në këtë rast, Ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008.

Korrigjimi është i domosdoshëm nëpërmjet ndërhyrjeve të nevojshme ligjore në Nenin 114/1 të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 duke unifikuar afatet e këtij neni me afatet e parashikuara në Ligjin nr. 9632.

5. AKSESI NË FINANCIM SI NJË INCENTIVË PËR FORMALIZIM

Niveli i ulët i rritjes ekonomike, rënia e kërkesës agregate dhe opsioneve për investime atraktive kanë çuar në një tkurrje të financimit të bankave dhe kërkesa më të forta ndaj bizneseve. Ka një fenomen tjetër në rritje që po konfirmohet edhe nga anketa, kreditimi informal me interesa shumë të larta që po krijon një zinxhir borxhesh dhe vështirësi në formalizimin e tyre. Referuar edhe *Anketës mbi Informalitetin* del se kreditimi i biznesit është shumë i vështirë, (49% e përgjigjeve) dhe për pasojë nuk është e mundur të konsiderohet si një incentivë për formalizim (Figura 6).

Figura 6. Vështirësitë në kreditim si faktor i klimës së biznesit



Burimi: Përpunim i Sekretariatit nga Përgjigjet në Anketën e Informalitetit

Vlerësohen përpjekjet për uljen e nivelit të kredive të këqija në sistemin bankar nëpërmjet planit të masave të ndërmarra nga Qeveria dhe Banka e

Shqipërisë me mbështetjen e FMN-së, si edhe përpjekjet për finalizimin e projekt-ligjit të ri “Mbi Falimentimin në RSH” të përgatitur me mbështetjen e IFC-së. Këto masa mendohet se do t’i japin frymëmarrje sektorit bankar dhe do të ndikojnë në rritjen e kreditimit për sektorin privat.

Nga ana tjetër ekzistojnë disa programe grantesh dhe kredite nga ana e qeverisë dhe donatorëve (AZHBR, AIDA, IPARD, BERZH, etj.), që ofrojnë lehtësira për sektorë të caktuar (si agrobiznesi, eksportet, gratë në sipërmarrje, etj.), të cilat duhet të bashkërendohen e të mbështesin përpjekjet e Qeverisë për një reformë sa më të suksesshme.

6. MASAT NDËSHKIMORE NDAJ INFORMALITETIT

Eksperiencat ndërkombëtare sugjerojnë se forcimi i penaliteteve funksionon më mirë kur janë krijuar paraprakisht incentivat e duhura për t’u formalizuar dhe kur bizneset informale kanë një tranzicion më gradual drejt formalizimit. Nga ana tjetër duhet konsideruar që penaltetet (si për shembull në Brazil dhe Argjentinë) mund të ushtrojnë edhe efektin e kundërt në produktivitet dhe punësim³⁴.

Nga bizneset e përgjigjura në Anketë dhe ato të kontaktuara direkt, ka një miratim mbi nevojën e penaliteteve për të reduktuar informalitetin dhe luftuar konkurrencën e pandershme. Por, ka edhe një qëndrim pothuajse unanim mbi ashpërsimin jo racional të masave të ndëshkimit e vlerësuar edhe në kushtet kur ka shumë rezerva ndaj cilësisë së administratës tatimore dhe doganore dhe aftësisë për të marrë vendimmarrje të drejta. Nga ana tjetër ka shumë pikëpyetje mbi efektivitetin e sistemit të ankimimit përfshirë apelimin

³⁴ “Economic Informality: Causes, Costs and Policies, A literature Survey of International Experience”- Ana Maria Oviado.

tatimor dhe ankimimin në rrugët e sistemit gjyqësor. Nga Anketa e Sekretariatit (tetor 2015) mbi Kontrollin Tatimor doli qartë shqetësimi mbi funksionimin e strukturës së apelimit tatimor ku në vetëm 4% të rasteve u jepej e drejtë tatimpaguesve. Ndërkohë që edhe për këtë pjesë, administrata tatimore rajonale kishte sërish të drejtën e ankimimit në rrugë gjyqësore.

Gjithashtu, raportohet se Gjykatat Administrative³⁵ kanë një paralizim nga mbingarkesa e çështjeve, organika dhe infrastruktura e kufizuar si edhe mungesa e transparencës. Asnjë Gjykatë Administrative e Shkallës së Parë nuk ka faqe zyrtare në internet. Përveç vonesave në gjykim jashtë afatit ligjor 3 mujor, problem mbetet edhe cilësia e gjykimin ku bizneset ankohen për vendimmarrje të gjykatave në favor të administratës publike.

³⁵ Vetëm Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka regjistruar gjatë vitit 2014, 11.500 çështje të cilat duhet të gjykohen nga vetëm 7 gjyqtarë.


7. RAST STUDIMOR: INDUSTRIJA E PËRPUNIMIT TË QUMËSHIT³⁶

Në të gjithë zinxhirin e industrisë së përpunimit të qumështit, ka aktorë që operojnë në mënyrë informale (pa pasur NIPT dhe pa lëshuar fatura me TVSH). Këta “xhepa të zbrazët” krijojnë premisa për informalitet dhe çojnë drejt operacioneve problematike për aktorët e tjerë (ato formalë) në këtë zinxhir siç është paraqitur në skemën e mëposhtme.

Në veçanti, grumbulluesit informale të qumështit dhe baxhot informale jo vetëm që qarkullojnë volume të mëdha të qumështit dhe kapital të konsiderueshëm, por gjithashtu përmes operacioneve të tyre informale dëmtojnë përpjekjet për kontrollin e cilësisë dhe sigurisë së produkteve. Përderisa cikli i TVSH-së nuk është i mbyllur, rrjedhimisht nuk mund të jetë efektiv në mënyrë të mjaftueshme.

³⁶ Studimi i plotë është i publikuar në www.investment.com.al

Skema e zinxhirit të vlerës në përpunimin e qumështit



Transaksionet nëpërmjet sistemit bankar për të gjithë prodhuesit nuk janë një mënyrë efikase, për më tepër duke pasur parasysh se shumica e tyre duhet të udhëtojnë në distanca të gjata për të arritur bankat në qytete dhe shuma e parave të marra nga shitja e qumështit është shumë e vogël në krahasim me përpjekjet, kohën e harxhuar dhe shpenzimet.

Ka mungesë informacioni dhe vështirësi në ndërgjegjësimin e fermerëve mbi legjislacionin tatimor dhe ndryshimet e tij, si dhe të gjithë skemën e formalizimit. Kapacitetet administrative rajonale përgjegjëse janë të kufizuara dhe shpesh jo afër fermerit për t'i asistuar.

Problemet në regjistrimin e tokës dhe tregu i saj, identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve, mungesa e besueshmërisë së të dhënave statistikore kërkojnë adresim të qartë për të mundësuar formalizimin afatgjatë të sektorit.

Në kutinë më poshtë jepet një pasqyrë më e detajuar e zinxhirit ushqimor dhe dy shembuj përkatësisht mbi koston e fermerit për transfertat bankare dhe vazhdimin e zinxhirit të TVSH-së.

Sektori i blegtorisë shqiptare është dhe do të mbetet pjesë e kërkesës në rritje për sasi dhe cilësi për t'iu përgjigjur nevojave të popullsisë. Edhe pse statistikat bujqësore nuk japin të dhëna plotësisht të besueshme dhe të sakta, disa prej shifrave që lidhen me sektorin e blegtorisë tregojnë se numri i fermave që merren me blegtori është 352.315; fermat që merren kryesisht me gjedh janë 214.970, ato që merren kryesisht me dhi janë 23.445 dhe dele 47.039. Sasia e qumështit në një nivel prej 1.133.000 ton në vit prodhohet nga 358.000 lopë, 1.896.000 dele dhe 904.000 dhi³⁷. Për shkak të menaxhimit

37 Instituti i Statistikave, INSTAT (2014)

më të mirë, tendenca (edhe pse shumë e ngadaltë) është drejt uljes së numrit të krerëve të bagëtive dhe rritjes së prodhimit të qumështit dhe mishit.

Rreth 80% (ose 170.000 ferma me gjedh) kanë nga 2 deri në 4 lopë, rreth 15% (ose 35.000 ferma me gjedh) kanë nga 5 deri në 10 lopë, rreth 4% (ose 9.000 ferma me gjedh) kanë nga 10 deri në 15 lopë, dhe vetëm 1% (ose 2.500 ferma me gjedh) kanë mbi 15 lopë. Qumështi përpunohet në baxho, të cilat afërsisht janë llogaritur të jenë 450, nga të cilat rreth 35% kryejnë veprimtari në mënyrë formale (të regjistruara, me tatim mbi vlerën e shtuar - TVSH), ndërsa 65%³⁸ veprojnë në mënyrë informale.

Një skemë pagese direkte për zonë (skemë subvencionit) me një vlerë totale prej 6 milionë Euro filloi të zbatohet për herë të parë në vitin 2006. Aktualisht, mbështetja e Qeverisë për sektorin e bujqësisë është 12,5 milion Euro, që në rastin e blegtorisë i adresohet fermerëve të regjistruar në mënyrë të ligjshme (NIPT), sipas skemës së TVSH-së, që bëjnë identifikimin dhe regjistrimin e bagëtive.

Është përgatitur një regjim i veçantë për formalizimin e prodhuesit të bujqësisë dhe kompensimin e TVSH-së³⁹. Në bazë të Udhëzimit Nr. 19, blerësi i produkteve bujqësore është subjekt i TVSH-së dhe taksave të tjera dhe ndjek një regjim normal TVSH-je. Blerësi lëshon një faturë TVSH-je për çdo produkt bujqësor të blerë nga fermerët (auto-faturë), ku cilësohet shitësi (prodhues) i produkteve bujqësore, NIPT-i i shitësit dhe të dhëna të tjera siç

38 Shoqata e Përpunuesve të Qumështit dhe të Mishit (ADAMA).

39 Udhëzim i Ministrit të Financave Nr. 19, datë 3 Nëntor 2014 "Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar".

kërkohej në formën e miratuar të faturës. Vlera totale e faturës përfshin vlerën që i është paguar fermerit, duke përfshirë normën e kompensimit të fermerit prej 20%. Kjo vlerë prej 20% ka për qëllim të mbulojë TVSH-në e paguar nga fermerët për blerjen e inputeve dhe shërbimet për prodhimin e produkteve bujqësore. Me Udhëzimin Nr. 26, datë 26.10.2015 të Ministrit të Financave u përcaktua se blerësi nuk ka të drejtë të kreditojë 20% të TVSH-së në rast se nuk provon kryerjen e kompensimit të fermerit përmes transaksioneve bankare (nga llogaria bankare e blerësit në llogarinë bankare të fermerit), ose përmes Shërbimit Postar të Shqipërisë. Sipas DPT, fermerët me një qarkullim vjetor nën 5 milionë ALL nuk konsiderohen tregtarë dhe në këtë rast mbajtja e NIPT-it është e nevojshme vetëm për qëllimin e kompensimit të TVSH-së. Fermerët me xhiro vjetore mbi 5 milionë lekë duhet të regjistrohen si tatimpagues normalë që përdorin fatura me TVSH. Aktualisht vetëm rreth 20.000 fermerë kanë marrë NIPT⁴⁰.

ZINXHIRI I VLERAVE DHE AKTORËT E TIJ

Veprimtaritë në sektorin e nënprodukteve të qumështit përfshijnë furnizuesit e mallrave dhe shërbimeve, prodhuesit, grumbulluesit e qumështit, përpunuesit e qumështit, transportuesit, shitësit me shumicë, shitësit me pakicë, tregjet dhe përdoruesit fundorë. Në vijim, secili prej aktorëve analizohet në funksion të formalitetit dhe informalitetit të veprimtarisë. Industria e prodhimit të qumështit përfshin disa furnizues të mallrave dhe ofrues shërbimesh të tilla si: kompanitë e farave (misër, jonxhë); furnizuesit e foragjereve

40 Drejtoria e Politikave Bujqësore, MBZHRAU

(koncentrate), furnizuesit e elementëve mineralë dhe vitaminave; farmacitë veterinarë; furnizuesit e spermës; shërbimin veterinar; shërbimin e mbarështimit artificial; shërbimin e mekanizimit. Aktualisht, shumica e furnizuesve të inputeve janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së, ndërkohë që në shumë raste veterinerët, teknikët e insemimit artificial dhe operatorët e pajisjeve mekanike nuk janë të regjistruar si tatimpagues. Siç u përmend më sipër, vetëm 20.000 fermerë kanë marrë deri më tani NIPT-in, përmes të cilit kanë hyrë në skemën e kompensimit të TVSH-së, në bazë të faturave me TVSH të përgatitura nga blerësit. Megjithatë, pjesa më e madhe e fermerëve nuk janë regjistruar ende.

Grumbulluesit e qumështit. Ka dy lloj grumbulluesish qumështi: *individë* që grumbullojnë qumështin dhe ua shesin baxhove (fabrikave të vogla apo të mëdha), ose direkt konsumatorëve ruralë; dhe *grumbulluesit* e punësuar nga industria përpunuese. Të parët në shumë raste janë informalë, ndërsa të dytët janë pjesë e stafit të industrisë së nënprodukteve të qumështit.

Përpunuesit. Nga 450 njësi (njësi të vogla përpunimi, ose "baxho" dhe fabrika) rreth 300 prej tyre operojnë në mënyrë informale dhe vetëm 150 janë të regjistruara dhe funksionojnë si biznese formale. Shumë prej njësive të paligjshme shërbejnë për të furnizuar popullsinë lokale rurale. Për shkak të detyrimit për zbatimin e ligjit, *transportuesit* janë duke operuar në mënyrë formale, sidomos ata që transportojnë qumështin dhe nënproduktet e tij drejt zonave urbane. *Shitësit me shumicë dhe pakicë* gjithnjë e më shumë po veprojnë në një mënyrë të formalizuar, veçanërisht ata shitës me shumicë dhe pakicë që shesin në zonat urbane.

SHEMBULLI 1: PAGESAT PËRMES SISTEMIT BANKAR PËR FERMERIN

Volumi i qumështit i shitur çdo ditë: 70%-80% e fermerëve shesin deri në 10-15 litra qumësht në ditë. Çmimi i qumështit: 38 ALL/litër. Fitimi ditor: 380-570 ALL. Pagesat nga blerësi janë bërë çdo 10 ose 15 ditë, kështu që shuma e përgjithshme për pagesë (ose transaksion) luhetet nga 3.800-5.700 ALL (në 10 ditë), ose 5.700-8.550 ALL (në 15 ditë). Distanca mesatare e fermave nga qendrat e qyteteve ku gjenden bankat është midis 40-50 km. Kostoja e transportit është rreth 400 ALL. Për të marrë shërbimin duhen së paku 3 orë, i cili i konvertuar në ALL është rreth 400 ALL. Komisionet bankare të përmuajshme luhaten nga 150 - 500 ALL.

Shpenzimet totale për çdo tërheqje të pagesës përmes sistemit bankar janë midis 950 – 1.300 ALL.

Për shkak të transaksioneve nëpërmjet sistemit bankar, shpenzimet e fermës kundrejt të ardhurave të nxjerra nëpërmjet shitjes së qumështit janë llogaritur të jenë midis:

16,6% deri në 25% kur pagesat bëhen çdo 10 ditë dhe detyrimet bankare janë 150 ALL;

11,1% deri në 16,6% kur pagesat bëhen çdo 15 ditë dhe detyrimet bankare janë 150 ALL; 22,8% deri në 34,2% kur pagesat bëhen çdo 10 ditë dhe detyrimet bankare janë 500 ALL; 15,2% deri në 22,8% kur pagesat bëhen çdo 15 ditë dhe detyrimet bankare janë 500 ALL.

SHEMBULLI 2: BAXHOT E PAREGJIS-TRUARA

Sasia minimale e qumështit të përpunuar në një baxho është 500 lit./ditë. Në rastin kur baxhot funksionojnë gjatë të gjithë vitit, kapaciteti vjetor i përpunimit është 500 lit. x 365 ditë = 182.500 lit. Çmimi i blerjes: 38 ALL/lit. X 182.500 lit = 6.935.000 ALL/qumësht në vit.

Nga kjo sasi e qumështit të grumbulluar është prodhuar 26.071 kg djathë. Çmimi i shitjes së djathit: 350 ALL/kg (çmimi minimal i mundshëm), xhiro vjetore: 9.124.850. ALL

Shënim: Duke marrë parasysh argumentin e mësipërm, rekomandohet që të gjitha njësitë e përpunimit duhet të jenë pjesë e sistemit të faturave me TVSH, përndryshe konkurrenca e padrejtë do të rritet dhe cilësia e produkteve do të mbetet problematike. Përveç kësaj, për sa i përket standardeve të operacioneve, të gjitha baxhot duhet të inspektohen në mënyrë rigorozë nga autoritetet kompetente.

REKOMANDIMET

Ka një konsensus të gjerë mbi nevojën për formalizim të ekonomisë dhe avantazhet që ka ky proces për rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare, thithjen e investimeve serioze dhe rritjen ekonomike afat-gjatë. Por nga ana tjetër, ka akoma paqartësi për biznesin mbi hapat e mëtejshëm, shtrirjen në kohë të aksionit të ndërmarrë dhe mungesë informimi mbi planin e veprimit. Eksperiencat botërore kanë treguar se përqasja ndaj formalizimit (një përmbledhje në Shtojcën 3) nënkupton një reformë të shtrirë në kohë dhe në dimensione ligjore dhe institucionale, ofrimin e incentivave ashtu si dhe shtrëngimin e penalteteve, mbrojtjen e shtresave në nevojë dhe të disa sektorëve që kanë pasur tendencën për të qenë më informalë. Megjithëse Ministri i Financave ka deklaruar në media përgatitjen e një plani 2-vjeçar në dhjetor⁴¹, ende nuk ka asnjë dokument qeveritar në lidhje me platformën e masave, nëse ka analiza sektoriale mbi të cilat do të merren këto masa. Për më tepër grupet e interesit shprehen për nevojën e konsultimit paraprak dhe do-

mosdoshmërinë e partneritetit në këtë fushatë. Sipas literaturës ndërkombëtare⁴², për reduktimin e informalitetit sugjerohet që të merren në konsideratë tre parime kryesore:

- Përqasja graduale për formalizim nëpërmjet përgatitjes, diskutimit dhe zbatimit të Strategjisë së integruar kundër informalitetit;*
- Kujdes për radhën e masave që merren. Rregullat e forta duhet të vijnë mbasi të jenë aplikuar rregullat e mira. Nëse luftohet ekonomia informale me represion ndërkohë që kemi probleme me zbatimin e ligjit, rrezikon më tepër të dëmtohet ekonominë dhe rritësh papunësinë.*
- Ndërtimi i kapitalit social. Është e rëndësishme të synohet rritja e transparencës dhe lufta kundër korrupsionit. Edhe rregullat e mira mund të mos funksionojnë nëse ka nivel të ulët të kapitalit social dhe institucione të dobëta.*

Referuar gjetjeve dhe analizës me grupet e interesit, rekomandimet janë orientuar në pesë shtylla kryesore të detajuara në vijim:

⁴¹ <http://www.ata.gov.al/operacioni-kunder-informalitetit-cani-do-te-siguroje-rritjen-e-pagave-dhe-uljen-e-taksave>

⁴² The shadow economy and how to fight against it [with focus on Moldova and the best Slovak experience], Peter Golias, Institute for economic and social reforms (INEKO) Slovakia (prill 2013).

1. REFORMË FORMALIZIMI-PARTNERITET ME BIZNESIN

REKOMANDIM 1 – AFATSHKURTËR

Përgatitja dhe miratimi nga Këshilli i Ministrave i një Strategjie të mirëfilltë kundër ekonomisë informale mbi bazën e analizave sektoriale, që konsideron punën e deritanishme dhe krijon imazhin e një angazhimi serioz afatgjatë të Qeverisë.

Dokumenti të shoqërohet me një plan veprimi, me qasje sektoriale, afate kohore dhe institucione përgjegjëse të mirëpërcaktuara, të konsultuara dhe bashkërenduara me përfaqësuesit e biznesit. Dokumenti të publikohet dhe procesi i hartimit të jetë transparent dhe gjithëpërfshirës. Formalizimi të jetë gradual dhe të mbështetet në një platformë me rregulla të qarta për biznesin. Kjo për faktin sepse sektorë të ndryshëm kanë specifika të ndryshme fiskale dhe sociale që ndikojnë mbi nivelin e informalitetit, p.sh., sektori i energjisë apo sektori bankar janë më tepër formalë dhe të rregulluar në krahasim me agrobiznesin ku vihet re një shkallë e lartë e informalitetit.

2. SISTEM TATIMOR I PËRGJEGJSHËM KUNDREJT FORMALIZIMIT

REKOMANDIM 2 – AFATMESËM

Rivlerësim dhe analizë e sistemit fiskal aktual [barra dhe politika] nëse dekurajon apo inkurajon formalizimin mbi bazën e elementeve të mëposhtëm:

a. Debatë mbi prapën e TVSH/Tatim Fitimi

» Ekspertë fiskalë dhe shumë sipërmarrje rekomandojnë për rishikimin në tendencë ulje të pragut të TVSH-së për të mos shkëputur zinxhirin e saj, ndërsa të tjerë nuk shikojnë prapën e TVSH-së si problem, por vendosin theksin në përsosjen e administrimit tatimor. Pragu i tatim

fitimit për efekt të zbatimit të shkallëzuar të tij në varësi të të qenit biznesi madh/biznesi vogël duhet të garantojë trajtim të drejtë të tatimpaguesve dhe jo të krijojë hapësira për shmangie tatimore. Ndërkohë, vëmendja duhet të përqëndrohet tek thjeshtimi i procedurave të pagesave në tatime dhe dogana, nivelet e përdorimit dhe efektivitetit të kasave fiskale (turizëm, bujqësi, etj.), analizën dhe dokumentimin e firove apo edhe tatimin e të ardhurave, të zbatueshëm në varësi të profesioneve. Përshkallëzimi i penaliteteve apo edhe gjobave dhe perceptimi i korrupsionit që shoqërohet me to, kërkojnë një analizë më të thelluar përfshirë kostot dhe përfitimet e ndërsjellta.

b. Incentiva që mund të shoqërojnë luftën ndaj informalitetit

- » Lehtësira fiskale për sipërmarrjet e reja, ato që riinvestojnë në një shumë të caktuar fitimet, sipërmarrjet që punësojnë një numër të caktuar apo edhe ato që kryejnë aktivitet në zona të pazhvilluara. Të shikohet mundësia e zbatimit të tatimeve të diferencuara në zona të caktuara të vendit.
- » Vlerësim mbi efektivitetin e çmimeve të referencës në dogana, nëse janë shkak për kontrabandë dhe evazion. Heqja e çmimeve të referencës identifikohet nga sipërmarrjet si një incentivë potenciale si p.sh. nga importuesit e pllakave, të materialeve të ndërtimit, veshjeve, etj.
- » Incentiva të qarta për konsumatorin për marrjen e kuponit tatimor, duke mundësuar përfitime të drejtpërdrejta nga deklarimi i të ardhurave vjetore.
- » Në bujqësi skema e subvencioneve nuk është mjaftueshëm nxitëse për formalizim sepse arrin vetëm tek një kategori e kufizuar fermerësh. Sugjerohet forcimi i skemës aktuale për incentivimin e tyre nëpërmjet rim-

bursimit të TVSH-së. Në sektorin e verërave për shkak të numrit të madh të licencave dhe lejeve të nevojshme apo në sektorët e bimëve medicinale dhe përpunimit të qumështit, situata është më e komplikuar dhe kërkon analizë më të thelluar.

REKOMANDIM 3 – AFATSHKURTËR

Thjeshtim i burokracive administrative duke synuar reduktimin e numrit dhe kohës së kryerjes së pagesave në veçanti për biznesin e mesëm, të vogël dhe mikro, dhe vendosja në dispozicion të tatimpaguesve të shërbimeve inovative, si p.sh. pagimi i taksave dhe tatimeve online duke përdorur shërbimet financiare jo-bankare, etj. Parë në këndvështrimin se 90% e bizneseve janë mikro dhe ka një nivel shumë të ulët të ndërgjegjësimit dhe njohurive financiare të bizneseve⁴³, këto masa do të jenë shumë lehtësuese.

REKOMANDIM 4 – AFATSHKURTËR

Rritja e përgjegjshmërisë së administratës për t'iu përgjigjur reformës së formalizimit nëpërmjet:

- a) *Transparencës së investimit dhe përshpejtimin në modernizimin e teknologjisë së informacionit si p.sh. mirëfunksionimi i sistemit të ri të tatimeve dhe sistemit të riskut që duhet t'i paraprijnë aksioneve në terren duke rritur kështu besueshmërinë e publikut.*
- b) *Specializimit të administratës, veçanërisht asaj tatimore dhe doganore⁴⁴.*

⁴³ <http://www.monitor.al/shqipëria-e-parafundit-në-botë-për-njohuri-financiare/>

⁴⁴ Referoju rekomandimeve të Këshillit të Investimeve në mbledhjen e dytë <https://www.investment.com.al/sq/events/mbledhja-nr-2-5-tetor-2015-1600-2/>

- c) *Ngritjes së strukturave të shpejta efektive apelimi si dhe këshillimit dhe përgatitjes së komentareve dhe manualeve për inspektorët dhe sipërmarrjet lidhur me të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta.*

3. SISTEMI RREGULLATOR, MBËSHTETËS I FORMALIZIMIT

REKOMANDIM 5 – AFATMESËM

Reforma për formalizim duhet të ketë si objekt edhe lehtësimin e barrës administrative për tatimpaguesit duke nxitur pajtueshmërinë me sistemin tatimor dhe sistemin rregullator dhe një standard më të lartë të të mirave dhe shërbimeve finale në aspektet e mëposhtme:

- a) *Përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve publike në drejtim të aplikimit të sistemeve online dhe rritje të shkëmbimit të informacionit në kohë reale. Konkretisht, koordinimi online i inspektoriateve Shtetërore dhe shkëmbimi i informacionit mbi kontrollin mbi biznesin, por edhe regjistrimin e koordinuar të aktiviteteve private si p.sh. QKR, Tatimet, Zyrën e Punës, dhe Inspektoriatet e tjera (p.sh. AKU, Inspektoriatet e Mjedisit, etj.) apo Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për importet e lëndëve të para (sidomos ato në agro-industri).*
- b) *Kategorizim i saktë i profesioneve si në aspektin ligjor ashtu dhe atë administrativ, si edhe harmonizimi i tyre ndërmjet QKR, Tatimeve dhe INSTAT për të mos krijuar ngatërresa tek tatimpaguesi dhe diferenca në trajtim nga administrata tatimore, si p.sh. rasti i profesioneve të lira.*
- c) *Unifikimi i strukturave të hetimit dhe kontrollit të administratës tatimore dhe doganore për të mundësuar një kontroll dhe zbulim efektiv të shmangieve tatimore, por edhe shkëmbim informacioni dhe ekspertize.*

- d) *Njohja e Kartave Teknologjike për operacione të caktuara, sidomos në agro-industri dhe rakkordimi me administratën tatimore për njohjen e firove përkatëse.*
- e) *Përcaktim i qartë ligjor i tregjeve të shumicës dhe pakicës⁴⁵ për të shmangur kalimin nga një status në një tjetër. Të përcaktohet qartë definicioni i ambulantit. Ripërcaktim i funksioneve të kontrollit ndaj tyre nga institucionet qendrore dhe lokale.*
- f) *Të mundësohet lidhja e NIPT-it të fermerit me regjistrin elektronik të tokës dhe regjistrin elektronik të kafshëve, etj.*
- g) *Formalizimi në bujqësi duhet të paraprihet nga përfundimi i regjistrimit të tokës, formalizimi i tregut të tokës, regjistrimi i fermave dhe gjësë së gjallë dhe përmirësimi i statistikave zyrtare.*
- h) *Rritja e kapaciteteve dhe funksioneve koordinuese të institucioneve përgjegjëse në varësi të Ministrisë së Bujqësisë së Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave që vendosin dhe monitorojnë standartet dhe cilësinë e zinxhirit në agro-industri nga lëndët e para, ndihmëse deri tek produkti final.*

KARTAT TEKNOLOGJIKE DHE STANDARDET NË PËRPUNIMIN E QUMËSHITIT

Është e nevojshme që disa karta teknologjike dhe standarde të përgatiten/përditësohen, miratohen dhe zbatohen. Procesi duhet të përfshijë MBZHRAU, AKU, Qendrat e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore (QTTB), autoritetet veterinarë, operatorët e ndërzimit artificial, furnizuesit e in-

puteve, OJQ-të përkatëse, etj. Disa prej kartave kryesorë të teknologjisë duhet të përfshijnë:

- » Ndërtimin e hambarëve
- » Ndërtimin e magazinave të foragjereve
- » Ndërtimin e magazinave për pajisjet mekanike
- » Ndërtimin e hapësirave për përpunimin e qumështit
- » Standardet e qumështit dhe standardet e përpunimit të qumështit
- » Humbjet e pritshme nga proceset teknologjike
- » Mbetjet nga barnat veterinarë

Rekomandohet që çdo degë e sektorit të blegtorisë dhe nënprodukteve të qumështit duhet të nxjerrë një listë të mallrave, shërbimeve, operacioneve që kërkojnë ndërhyrje për përgatitjen/përditësimin e grafikëve të teknologjisë dhe standardeve për zbatim, të pasuara nga propozimet e përgatitura nga grupet e punës të ekspertëve.

4. AKSESI NË KREDI DHE SHËRBIMET FINANCIARE—FAKTORË INCENTIVUES PËR FORMALIZIMIN

REKOMANDIM 6 - AFATSHKURTËR

- a) Të konsiderohet *bashkëpunimi i mëtejshëm me institucionet financiare bankare dhe institucionet financiare jo-bankare* në kontekstin e strategjisë së formalizimit dhe përfitimeve të tij, p.sh. institucionet e mikrokredisë mund të luajnë rol të rëndësishëm për uljen e ekonomisë informale veçanërisht në zonat rurale në të cilat ato

- kanë akses më të madh.
- b) Ndryshimet e fundit në kanalizimin e pagesave për fermerët nga grumbulluesit nëpërmjet sistemit bankar kërkojnë një *analizë më të thellë mbi pragun dhe kategorinë e fermerëve* që duhet të kalojnë nëpërmjet sistemit bankar në kontekstin kur popullsia rurale ka akses shumë të kufizuar në sistemin bankar dhe kur kostot e shërbimeve të këtij të fundit janë të larta.
- c) *Inkurajimi i transaksioneve bankare dhe pagesave elektronike* si p.sh. nëpërmjet PoS sidomos në tregti dhe shërbime. Zbatimi nga administrata tatimore i parashikimeve ligjore ekzistuese që nuk detyrojnë pajisjen me kasë fiskale në rastin kur tatimpaguesi nuk kryen arkëtime me para në dorë, ndihmon bizneset e vogla duke reduktuar kostot. Për këtë qëllim MF dhe DPT duhet të unifikojnë interpretimet lidhur me raste të tilla.

5. KONSULTIM, TRANSPARENÇË DHE EDUKIM

REKOMANDIM 7 - AFATSHKURTËR

Të zbatohet ligji nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" i cili rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik dhe paraparak të projektligjeve, projekt dokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik.

REKOMANDIM 8 - AFATMESËM

- » *Programet e granteve dhe kreditimit* të Qeverisë dhe donatorëve, mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në *ndërgjegjësimin dhe këshillimin* për formalizim të grupeve të caktuara të sektorit privat p.sh. 2-3 vitet e para duke mbështetur aksionin e Qeverisë. Konkretisht, rekomandohet që skemat e subvencioneve qeveritare duhet të çojnë në rritjen e gatishmërisë dhe interesit të fermerëve për formalizimin dhe veprimin në përputhje me standardet e sigurisë ushqimore. Kështu, skemat kombëtare të subvencioneve për sektorin e qumështit duhet të bazohen në volumin dhe cilësinë e produkteve.
- » Sugjerohet që në bujqësi të ofrohet më shumë *këshillim dhe ndërgjegjësim* për fermerët. Të konsiderohet *krijimi i një strukture të ndërmjetme që të ofrojë asistencë dhe informacion për fermerin* për regjistrim e tij dhe përfitimet nga formalizimi me ndihmën e donatorëve ose të Qeverisë.
- » Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere të targetuara në bashkëpunim edhe me shoqatat e biznesit apo partnerë të tjerë privatë siç janë institucionet e mikrokreditimit në zonat rurale.
- » Vlerësim publik për bizneset e rregullta në vite apo edhe nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave nëpërmjet Administratës Tatimore me biznese të tjera.

⁴⁵ Përkufizimet e tyre në pikën 59.2.2 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr. 24 datë 02.09.2008 të vend për interpretime dhe nuk është i qartë.

SHTOJCA 1

Madhësia e ekonomisë informale në 27 vendet e BE-së ndaj PBB-së, 2003-2012

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Austria	10,8	11	10,3	9,7	9,4	8,1	8,5	8,2	7,9	7,6
Belgjikë	21,4	20,7	20,1	19,2	18,3	17,5	17,8	17,4	17,1	16,8
Bullgari	35,9	35,3	34,4	34	32,7	32,1	32,5	32,6	32,3	31,9
Qipro	28,7	28,3	28,1	27,9	26,5	26	26,5	26,2	26	25,6
Republika Çeke	19,5	19,1	18,5	18,1	17	16,6	16,9	16,7	16,4	16
Danimarka	17,4	17,1	16,5	15,4	14,8	13,9	14,3	14	13,8	13,4
Estoni	30,7	30,8	30,2	29,6	29,5	29	29,6	29,3	28,6	28,2
BE-27 (mesatarja e thjeshtë)	22,3	21,9	21,5	20,8	19,9	19,3	19,8	19,5	19,2	18,4
Finland	17,6	17,2	16,6	15,3	14,5	13,8	14,2	14	13,7	13,3
Francë	14,7	14,3	13,8	12,4	11,8	11,1	11,6	11,3	11	10,8
Gjermani	17,1	16,1	15,4	15	14,7	14,2	14,6	13,9	13,7	13,3
Greqi	28,2	28,1	27,6	26,2	25,1	24,3	25	25,4	24,3	24
Hungari	25	24,7	24,5	24,4	23,7	23	23,5	23,3	22,8	22,5
Irland	15,4	15,2	14,8	13,4	12,7	12,2	13,1	13	12,8	12,7
Itali	26,1	25,2	24,4	23,2	22,3	21,4	22	21,8	21,2	21,6
Letoni	30,4	30	29,5	29	27,5	26,5	27,1	27,3	26,5	26,1
Lituani	32	31,7	31,1	30,6	29,7	29,1	29,6	29,7	29	28,5
Luksemburg	9,8	9,8	9,9	10	9,4	8,5	8,8	8,4	8,2	8,2
Malta	26,7	26,7	26,9	27,2	26,4	25,8	25,9	26	25,8	25,3
Hollandë	12,7	12,5	12	10,9	10,1	9,6	10,2	10	9,8	9,5
Poloni	27,7	27,4	27,1	26,8	26	25,3	25,9	25,4	25	24,4
Portugali	22,2	21,7	21,2	20,1	19,2	18,7	19,5	19,2	19,4	19,4
Rumani	33,6	32,5	32,2	31,4	30,2	29,4	29,4	29,8	29,6	29,1
Sllovaki	18,4	18,2	17,6	17,3	16,8	16	16,8	16,4	16	15,5
Slloveni	26,7	26,5	26	25,8	24,7	24	24,6	24,3	24,1	23,6
Spanjë	22,2	21,9	21,3	20,2	19,3	18,4	19,5	19,4	19,2	19,2
Suedi	18,6	18,1	17,5	16,2	15,6	14,9	15,4	15	14,7	14,3
Mbretëria e Bashkuar	12,2	12,3	12	11,1	10,6	10,1	10,9	10,7	10,5	10,1

Burimi: Schneider F. (undated), "Size and Development of the Shadow Economy of 31 European and 5 other OECD Countries from 2003 to 2012: Some New Facts", http://www.econ.jku.at/members/Schneider/files/publications/2013/ShadEcEurope31_Jan2013.pdf

SHTOJCA 2

Anketa / Vlerësim mbi faktorët e informalitetit në ekonominë shqiptare

Kjo anketë është ndërmarrë nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve në kuadër të diskutimit të temës së informalitetit në mbledhjen e radhës së Këshillit të Investimeve (dhjetor 2015). Qëllimi i anketës është që të nxisë debatin mbi shkaqet e informalitetit dhe ofrojë sugjerime konkrete për trajtimin e duhur të fenomenit për të përmirësuar klimën e biznesit në Shqipëri dhe nxitur investimet në ekonomi.

Pyetësi është anonim dhe plotësohet online në nëpërmjet faqes së internetit të Këshillit të Investimeve. Kontributi juaj është thelbësor për të nxjerrë në pah shqetësimet e komunitetit të biznesit dhe për t'i adresuar ato në mënyrë profesionale dhe gjithëpërfshirëse në organet qeveritare.

- Aktiviteti kryesor ekonomik i biznesit tuaj është:
 - » Industri nxjerrëse
 - » Industri përpunuese
 - » Furnizim me energji elektrike, gaz e avull dhe me ajër të kondicionuar
 - » Aktivitete me ujë të ngrohtë, kanalizime, menaxhim të mbeturinave dhe rregullime
 - » Ndërtim

- » Shërbim
- » Tregti me shumicë dhe pakicë
- » Transport dhe magazinim
- » Hoteleri
- » Informacion dhe Komunikacioni
- » Aktivitete arkitekturore dhe inxhinierike
- » Agjenci udhëtimi, operator turistik
- » Të tjera (ju lutem specifikoni_____)

- Aksionerët më të mëdhenj (me mbi 50% të aksioneve) të biznesit tuaj janë:

- ☐ Vendas
- ☐ Të huaj

- Sa kohë keni qe operoni në treg?

- Madhësia e biznesit tuaj sipas xhiros së vitit të fundit është:

- ☐ 2 – 8 milionë ALL
- ☐ Mbi 8 – milion ALL

- A jeni subjekt i TVSH-së?

- ☐ Po
- ☐ Jo

6. A jeni klasifikuar si Biznes VIP nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve?

- ☐ Po
- ☐ Jo

7. Lutem përcaktoni nëse ndesheni me konkurrencë nga aktivitete informale në sektorin ku operoni?

- ☐ Po
- ☐ Jo

Nëse po, jepni komentet tuaja çfarë natyre ka informaliteti në sektorin tuaj (shmangie taksash, mosregjistrim, korrupsion, kontrabande, punë në të zezë, etj.) dhe në çfarë stadi të aktiviteteve shfaqet (regjistrimi i aktiviteteve, procesin e prodhimit, hyrjen e produktit/shërbimit në treg, importimit/eksportimit, marrëdhëniet me furnitorët, etj.)?

8. Lutem rendisni në një shkallë nga 1 deri në 5 (ku 1 është shumë i lehtë/i vogël dhe 5 është shumë i vështirë/i madh) në lidhje me të bërin biznes në Shqipëri referuar çështjeve të mëposhtme:

- ☐ Regjistrimi i biznesit (nga 1 në 5)
- ☐ Licencimi i aktiviteteve (nga 1 në 5)
- ☐ Numri i taksave (nga 1 në 5)

☐ Procedurat për të qënë korrekt me taksat (si p.sh. koha e harxhuar, kosto e shërbimit, mënyra e pagesës, etj.) (nga 1 në 5)

☐ Barra fiskale (si kufiri i TVSH-së, sigurimet shoqërore, tatimi mbi fitimin, etj.) nga 1 në 5)

☐ Punësimi i punonjësve (nga 1 në 5)

☐ Kreditimi i biznesit nga sektori bankar (nga 1 në 5)

☐ Importimi/eksportimi i mallrave dhe shërbimeve (nga 1 në 5)

☐ Inspektimet e ndryshme nga administrata shtetërore (nga 1 në 5)

☐ Prokurimi i fondeve publike (nga 1 në 5)

☐ Konsulenca (nga 1 në 5)

☐ Te tjera, _____

Komente/specifikime për sa më sipër, nëse keni:

9. Lutem jepni mendimin tuaj mbi shkaqet që nxisin informalitetin në sektorin ku jeni:

10. Në këndvështrimin tuaj a ka më shumë përfitim apo kosto të qenit informal (i pargjistruar/shmangie taksash) në sektorin tuaj dhe nëse mund të artikulonit më në detaje:

11. Nëse keni disa informalitet në biznesin tuaj a keni strategji për t'u formalizuar në afat të gjatë?

- ☐ Po
- ☐ Jo

12. A mendoni se janë të nevojshme penalitetet për të reduktuar informalitetin në ekonomi? Nëse po, në çfarë mase i shikoni si të efektshme?

13. Cilat mendoni se mund të jenë disa incentive të efektshme për të reduktuar informalitetin në sektorin tuaj?

14. A mund të sugjeroni disa incentive në formalizimin e ekonomisë shqiptare në tërësi?

SHTOJCA 3

Matricë përmbledhëse me disa eksperiencat ndërkombëtare për reduktimin e ekonomisë informale

EKSPERIENCAT E VENDEVE TË TJERA MBI MASAT PËR REDUKTIMIN E INFORMALITETIT

SHËNIM: PËR LEHTËSI KËRKIMI, BURIMET JANË LËNË QËLLIMISHT NË GJUHËN E TYRE ORIGINALE

BURIMI: "TACKLING THE UNDECLARED ECONOMY IN FYR MACEDONIA: A BASELINE ASSESSMENT 2014 [ADAPTED FROM WILLIAMS, BARIC AND RENOY - 2013]"

PËRMBLEDHJE E MASAVE NË 31 – VENDET E BE-SË

MASAT NDËSHKUESE

- » Penalitete administrative për blerësit/kompanitë
- » Penalitete administrative për ofruesit, punëdhënësit
- » Penalitete penale për blerësit/kompanitë
- » Penalitete penale për ofruesit/punëdhënësit

MASA PËR TË PËRMIRËSUAR ZBULIMIN

- » Ndarja e të dhënave dhe përputhja e tyre
- » Inspektim në vendin e punës
- » Regjistrimi i punonjësve përpara fillimit të punës ose ditën e parë të punës
- » Koordinim i strategjisë ndërmjet qeverisë
- » Certifikim i bizneseve, certifikim i pagesave të kontributeve sociale dhe taksave
- » Përdorimi i survejimit nëpërmjet denoncimeve
- » Koordinim nëpërmjet institucioneve qeveritare
- » Shkëmbim i të dhënave ndërmjet institucioneve qeveritare
- » Karta e punës e detyrueshme në vendin e punës

MASAT PARANDALUESE

- » Reduktimi rregullimeve
- » Thjeshtim i procedurave të përputhshmërisë
- » Novacionet teknologjike (si pajisjet për regjistrimin e parasë në dorë)
- » Kategori të reja të punës
- » Incentiva direkte taksash (si p.sh. përjashtime, zbritje)
- » Incentiva të sigurimeve shoqërore
- » Tranzicioni i butë nga i papunë në të vetëpunësuarit
- » Ndryshim i pagës minimum në rritje
- » Ndryshim i pagës minimum në ulje
- » Trajnim dhe mbështetje për bizneset start-up
- » Mikrofinancim për bizneset start-up
- » Këshillim si të formalizohen
- » Lidhjen me skemën e pensioneve me punën formale
- » Prezantimi i përgjegjësive të zinxhirit të ofruesve
- » Kufizimi i lëvizjes së lirë të punëtorëve të huaj

MASAT KURUESE

- » Nxitja e blerësve për të blerë të mira dhe shërbime të deklaruara
- » Kuponat e shërbimeve
- » Incentivë taksash direkte
- » Incentivë taksash indirekte
- » Nxitja e ofruesve për t'u formalizuar
- » Amnisti të gjerë sociale
- » Amnisti në nivel individual për deklarim vullnetar
- » Reduktim të targetuar të TVSH
- » Programe kompjuterike falas për bizneset për mbajtjen e të dhënave
- » Këshillim/trajnim falas për mbajtjen e të dhënave
- » Skema të formalizimit gradual

TË NXITET ANGAZHIMI PËR TË DEKLARUAR PUNËN

- » Fushata për të informuar punëtorët e padeklaruar mbi risqet dhe kostot e të punuarit të padeklaruar
- » Fushata për të informuar punëtorët e padeklaruar mbi përfitimet e formalizimit
- » Fushata për të informuar përdoruesit e punëve të padeklaruara mbi risqet dhe benefitet e formalizimit
- » Përdorimi i thirrjeve normative ndaj njerëzve për të deklaruar aktivitete
- » Masa për të ndryshuar drejtësinë e perceptuar të sistemit
- » Masa për të përmirësuar procedurat gjyqësore të sistemit (shkalla në të cilën njerëzit besojnë se qeveria i trajton me respekt, paanshmëri dhe mënyrë të përgjegjshme)
- » Masa për të përmirësuar njohuritë mbi taksat, kontributin shoqëror dhe ligjin e punës
- » Adoptimin e angazhimeve më tepër se përqasjen e pajtueshmërisë (*p.sh. responsive regulation*)
- » Fushata për të inkurajuar një kulturë angazhimi për të deklaruar

MAQEDONIA

PËRMIRËSIMI I ZBULIMIT

- » Inspektimet e Punës
- » Kontroll mbi pagimin e taksave dhe sigurimeve shoqërore. Krijimin e Qendrës për mbledhjen e borxheve", "Qendra për sekuestrim të të mirave", "Akademi e Taksave për trajnime" dhe një njësi investigimi për Drejtorinë e Tatimeve për të trajtuar mashtrimet me risk të lartë dhe evazionin fiskal;
- » Forcimi i bashkëpunimit administrativ dhe shkëmbimi i asistencës së përbashkët nëpërmjet shkëmbimit elektronik të të dhënave ndërmjet tatimeve dhe inspektoriatit të punës;
- » Rritja e penaliteteve dhe rritja e perceptimit të riskut për punën në të zezë.

MUNDËSI PËR FORMALIZIM

- » Thjeshtësimi i rregullave për fillimin e një biznesi;
- » Decentralizimi i shërbimit të pagimit të taksave si p.sh. hapja e Pikave të Shërbimit (2011);
- » Inkurajim për plotësimin elektronik të rimbursimit nga pagesa e taksave (*tax returns*) dhe pagesat elektronike për tatim-fitimin e korporatave dhe TVSH-në.

INCENTIVA DIREKTE TAKSASH

- » Reduktimin dhe barazimin e normës së taksës mbi korporatën dhe të të ardhurës personale (flat tax rate) në 10%;
- » Norma e taksës në 1,5% të totalit të të ardhurave për biznese të vogla me një qarkullim deri në 3 milion MKD;
- » Lehtësim taksash për përfitime të riinvestuara (për investime mbi 100.000 EUR);
- » Zero tatim mbi të ardhurën nga korporatat për fitimet e pashpërndara.

INCENTIVAT PËR PËRFSHIRJEN NË PUNËSIMIN ZYRTAR DHE OPERIMET E BIZNESIT

- » Reduktim të kostove të punëtorëve sezonale duke lehtësuar kërkesat për pagesat për shkurtim nga puna;
- » Bazë për taksim më të ulët për fermerët individual të regjistruar (20% të pagës neto kombëtare mesatare);
- » Fermerët me një të ardhur vjetore më të ulët se 300.000 MKD të përjashtuar nga pagimi i taksave.

NDËRGJEGJËSIM DHE FUSHATA PUBLIKE

- » Linja për raportimin e punës së padeklaruar;
- » Check-list për punëmarrësin dhe punonjësin për të drejtat e tyre ligjore dhe detyrimet;
- » Fushata promociionale që targetojnë të rinjtë dhe promovojnë kalimin e suksesshëm në punë të formalizuar.

GJEORGJI – “MSM TAX SIMPLIFICATION REFORM: CAN IT TACKLE INFORMALITY, WORLD BANK, IFC”

- » Përkufizimi i biznesit mikro, të vogël, të mesëm dhe të madh;
- » Zhvillimi i udhëzuesve për kontabilitetin tatimor për bizneset mikro;
- » Thjeshtim i raportimit për bizneset e vogla, pagesa dy herë në vit me zgjedhje.

“ECONOMIC INFORMALITY: CAUSES, COSTS AND POLICIES A LITERATURE SURVEY OF INTERNATIONAL EXPERIENCE, ANA MARIA OVIEDO”

RRITJE E PAJTUESHMËRISË ME TAKSAT

- » Reduktim të normave të taksave për rrogat e ulëta - Belgjika, Bullgaria, Holanda, Franca;
- » Përjashtim dhe ulje taksash në sektorët që mbështeten në punë të padeklaruar - Hungari, Suedi, Belgjikë dhe Francë;
- » Ulje të TVSH-së në sektorët me punë intensive - Holanda;
- » Fushata ndërgjegjësuese të targetuara dhe në bashkëpunim me shoqatat e tregëtisë për të trajtuar industritë me mundësi më të larta për mosrespekti - Australia, Belgjika dhe Suedia;
- » Ofrimi i skemave vullnetare për deklarime, fushata mediatike dhe interneti, "kupona" për punën, etj. - Mbretëria e Bashkuar, Belgjika, Australia;
- » Zëvendësimi i TVSH-së/tatimit mbi të ardhurat/kontributet e sigurimeve shoqërore të bizneseve të vogla me një taksë të vetme - Argjentinë, Bolivi, Brazil dhe Peru;
- » Një sistem i integruar për firmat e vogla dhe të mëdha unifikon pagesën e mbledhjes së taksave federale dhe kontributeve sociale. Të gjitha firmat poshtë 1.000.000 USD që punojnë në shërbime, tregti dhe prodhim -ose bujqësi janë të zgjedhshme, dhe përfaqësojnë 75% të regjistrimit të biznesit dhe 7% të PBB - Brazil;
- » Ky program zëvendëson 6 lloje taksash dhe 5 lloje kontributesh sociale me një taksë progresive mbi të ardhura bruto. Një aspekt tjetër është që ka shkëputur kontributet shoqërore nga numri i punonjësve të deklaruar ose pagat, duke i bërë kontributet në proporcion me të ardhurat e firmës – Brazil;
- » Krijimi i Qendrave të Shërbimit të Biznesit Service Centers që ofrojnë një numër shërbimesh për sipërmarrësit, nga informacioni dhe këshillimi tek lehtësirat për regjistrim - Kolumbi.

REDUKTIMI I BARRËS SË TAKSAVE PËR TË FORMALIZUARIT

- » Reduktim i taksës së fitimit mbi korporatën - Hungari, Poloni, Sllovaki;
- » Përrjashtim taksash për punësim të punëtorëve të paprivilegjuar - Hungari;
- » Lehtësim taksash në industritë me përqindje të lartë të punëtorëve të padeklaruar - Suedi, Belgjike, Francë;
- » Lehtësim taksash për punonjësit e rinj - Mal i Zi;
- » Falje taksash - Qipro, Turqia;
- » Përrjashtim taksash në fitimet e ri-investuara - Estoni;
- » Reduktim të barrës agregate të taksave (si një % ndaj PBB) (shumica e 27 vendeve të BE-së);
- » Rritje e pragut të të ardhurës së pataksueshme/futja e reduktimit të taksave për paga të ulëta - Bullgaria, Belgjika, Hollanda, Franca.

RRITJA E BAZËS SË TAKSIMIT

- » Futja e plotësimit online dhe pagesave online - Estonia;
- » Harmonizimi i rregullave/formave të taksave - Austria, Greqia, Hollanda, Franca, Portugalia, Danimarka;
- » Thjeshtësim i sistemit të taksave për SME-të - Kenia, Tanzania, Uruguaji;
- » Zëvendësimi i TVSH-së/taksës mbi të ardhurat/kontributit të sigurimeve shoqërore të bizneseve të vogla me vetëm një takse - Vendet e Amerikës Latine;
- » Vlerësim për Bizneset e Ndershme - 15 vendet e BE-së;
- » Rritje e fleksibilitetit në kontratat e përkohshme të punës - 15 vendet e BE-së.

"POLICY BREAf ON INFORMAL ENTREPRENEURSHIP - EUROPEAN COMMISSION"

- » Pragje dhe përrjashtim taksash, këshillim dhe trajnim dhe ofrim të benefiteve sociale për një periudhë të shkurtër kohore sa të fillojnë biznesin dhe shikojnë përfitime nga punësimi - Shembulli i Italisë me periudha të përkohshme dhe tarifa të reduktuara;
- » Ulje të taksave dhe kupona për punonjësit e paregjistruar nga këndveshtrimi i konsumatorit për të punësuarit në familje - Modeli Danimarkës.

"THE SHADOW ECONOMY AND HOW TO FIGHT AGAINST IT (WITH FOCUS ON MOLDOVA AND THE BEST SLOVAK EXPERIENCE) PETER GOLIAS, INSTITUTE FOR ECONOMIC AND SOCIAL REFORMS (INEKO) SLOVAKIA, APRIL 2013"

- » Reforma Hartz IV në Gjermani nga viti 2000 përcaktoi që "mini punët" me rroga mujore jo më pak se 400 EUR nuk do të ishin objekti i kontributit të sigurimeve shoqërore. Për rroga ndërmjet 401 Euro deri në 800 Euro, kontributi rritet gradualisht deri në pjesën e plotë;
- » Reforma e taksës së sheshtë në Sllovaki;
- » Unifikimi i taksës direkte mbi të ardhurat në 19% për individët dhe bizneset. Reforma zvogëloi edhe normën e taksës së fitimit mbi korporatat nga 25% në 19% dhe hoqi normën e taksimit të dividendit prej 15%;
- » Rriti taksën indirekte të konsumit. Nga sistemi i vjetër me TVSH me dy nivele me norma 20 % dhe 14% u unifikua në 19%;
- » Thjeshtime radikale të legjislacionit tatimor.

SHTOJCA 4

LITERATURA

1. BEEPS IV dhe BEEPS V - Vrojtimi për klimën e biznesit dhe performancën e ndërmarrjeve
2. "Business Environment Survey 2015" - Foreign Investors Association of Albania (FIAA)
3. Enterprise Surveys 2013, Albania Country Profile – World Bank, IFC
4. OECD - Investment Compact, The Informal Economy in Albanian, Analysis and Policy Recommendations, December 2004
5. Informal Sector in Developed and Less Developed Countries: A Literature Survey" - Klarita Gërçhani.
6. Policy Brief on Informal Entrepreneurship - European Commission and OECD- "The size of the informal economy in the EU-27, 2003-2012 -As a percentage of national GDP"
7. Working Papers, Private Sector and Labour Market Developmen in Albania: Formal versus Informal, Marta Muço, Peter Sanfey, Erjon Luçi and Genti Hashorva, April 2004
8. Action Plan of Strategy for Fight Against The Informal Economy (2008-2010), Turkey Presidency of Revenue Administration, April 2009"
9. Informality: Causes, Consequences, Policies - Background Paper prepared by Ana-Maria Oviedo for Country Economic Memorandum (CEM)
10. Informality, Inclusiveness, and Economic Growth: An Overview of Key Issues; James Heintz University of Massachusetts, Amherst, USA Political Economy Research Institute - July 2012
11. De Soto, Hernando. 1989. The Other Path: The Invisible Revolution in the Third World. New York: Harper and Row
12. Një studim krahasues mbi punësimin informal në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Moldavi dhe Mali i Zi (ILO)
13. Tax Compliance Cost in Albania IFC- IDRA (2013)

14. Does It Pay Firms to Register for Taxes? The Impact of Formality on Firm Profitability, David McKenzie, Yaye Seynabou Sakho (November 2007), IZA DP No. 3179
15. MSME Tax Simplification – Can it Tackle Informality? Rajul Awasthi - Global Tax Simplification Team, Investment Climate Department, World Bank Group
16. IMF Working Paper - What Causes Firms to Hide Output? The Determinants of Informality, Era Dabla-Norris, Mark Gradstein, and Gabriela Inchauste
17. OECD Economics Department Working Papers No. 896- Informality in Mexico, Nicola Brandt
18. Informal Economy in Albania, Merita Boka, Giuseppe Turlucci - Academic Journal of Interdisciplinary Studies, Vol 2 No 8, October 2013
19. Taxes, competition and finance for Albanian enterprises: evidence from a field study by Holger Muent, Francesca Pissarides and Peter Sanfey – July 2000
20. OECD Policy Roundtables: Competition Policy and the Informal Economy – 2009
21. OECD Economics Department, Working Papers No. 873 Policy Roundtables: Towards a Better Understanding of the Informal Economy
22. Discussion Paper on Economics, The Costs and Benefits of Informality by Nicoletta Batini (IMF and University of Surrey) and Paul Levine
23. Rethinking the Informal Economy: Linkages with the Formal Economy and the Formal Regulatory Environment, by Martha Alter Chen, July 2007 DESA Working Paper No. 46,
24. Taxing the Informal Economy, Challenges, Possibilities and Remaining Questions, Amuradha Joshi, IDS Working Paper, Volume 2013, No 429
25. Tackling the Undeclared Economy in FYR Macedonia, a Baseline Assessment A baseline assessment, Rositsa Dzhhekova, Josip Franic, Lyubo Mishkov and Colin C. Williams, 2014
26. The shadow economy and how to fight against it (with focus on Moldova and the best Slovak experience) Peter Golias, Institute for economic and social reforms (INEKO) Slovakia, April 2013
27. Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike - Ministria e Financave
28. Anketa e Forcës së Punës, T-2 2015, INSTAT
29. Artikuj në media (përfshirë por pa u kufizuar në gazeta, burime interneti, perceptime biznesi etj.)

RRETH KËSHILLIT TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomike
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council  ALInvestCouncil  Albania Investment Council